



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Financë” me profile:
“Bankë”, “Kontabilitet”, “Informatikë Ekonomike” dhe “Menaxhimi i
Organizatave”**

i

**Institucionit të Arsimit të Lartë
“Universiteti Europian i Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Drini Salko
2. Dr. Andromahi Kufo

Nëntor 2022

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



Për Programin e studimit Bachelor “Financë” me profile: “Bankë”, “Kontabilitet”, “Informatikë Ekonomike” dhe “Menaxhimi i Organizatave” i Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Europian i Tiranës”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Europian i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Financë” me profile: Bankë; Kontabilitet; Menaxhim i Organizatave; Informatikë Ekonomike
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM 255, datë 27/02/2008
5	Urdhri/VKM i riorganizimit:	Shkresë MASR Nr. 8244/1, datë 04.09.2018
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhri/VBA i akreditimit të parë:	UMAS Nr. 209, datë 28/04/2016
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite, 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit (2021- 2022):	38 PAE/ 1 PAK
18	Numri i studentëve (2019-2021):	243 studentë
19	Komente / të tjera:	-

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit (këtej e në vazhdim PS) Bachelor në "Financë" është hapur me vendim të MASH Nr. 255, datë 04.09.2008 dhe është rirorganizuar me shkresën e MAS nr.8244/1 datë 04.09.2018. Programi i studimit ka për qëllim përgatitjen e specialistëve në fushën e financës duke i specializuar në disa nëndege të saj, specifiku të "Bankë", "Kontabilitet", "Informatikë Ekonomike" dhe "Menaxhimi i Organizatave". PS është akredituar për herë të parë me Vendim të Këshillit të Akreditimit nr. 127, datë 18/02/2016 dhe UMAS nr.209 datë 28.04.2016. Programi i studimit realizohet me 181 kredite dhe kohëzgjatja normale është tre vite akademike. Programi i studimit Bachelor në "Financë" është organizuar në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL".

Qëllimi i programit të studimit siç përcaktohet nga vetë institucioni është pajisja e studentëve me "njohuri gjithëpërfshirëse mbi financën, vendimmarrjen dhe mjetet e zbatimit të funksionit financiar, në të gjithë tipet e sipërmarrjes, nga ndërmarrjet klasike, përfshirë ndërmarrjet "Banka" deri tek njohuritë mbi mjedisin financiar dhe lidhjet ndërmjet ndërmarrjeve dhe tregjeve financiare apo me shtetin".

Programi i studimit ofrohet nga Departamenti Ekonomik dhe Financës, i cili e ka filluar veprimtarinë e tij në vitin akademik 2008- 2009. Departamenti i Ekonomik dhe Financës ofron programe studimi në ciklin e parë dhe ciklin e dytë dhe ka një eksperiencë të gjatë në lidhje me ofrimin e programeve në fushën e financës duke aplikuar e përfshirë në kurikulat e veta lëndë sipas kërkesave të tregut të punës. Aktualisht departamenti ka në përbërjen e tij 17 akademikë me kohë të plotë dhe 1 akademik me kohë të pjesshme. Mësimdhënia në programin e studimit mbulohet kryesisht nga stafi me kohë të plotë i Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, Universiteti Europian i Tiranës. Personeli me kohë të plotë krahas angazhimit në mësimdhënie, është i përfshirë dhe në punë kërkimore-shkencore në funksion të mësimdhënies dhe zhvillimit ekonomik lokal/kombëtar.

Departamenti i Ekonomik dhe Financës, bashkëpunon me institucione të tjera të arsimit të lartë (kombëtare dhe ndërkombëtare) në fushën e mësimdhënies, organizimit të konferencave shkencore dhe pjesëmarrjen si partnerë në projekte të ndryshme. Departamenti bashkëpunon gjithashtu me institucione të tjera private dhe publike për arritjen e objektivave të tij në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit.





Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm;

Universiteti Europian i Tiranës ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit të programit Bachelor në Ekonomiks nëpërmjet shërbimit AMS. ASCAL dhe Bordi i Akreditimit përzgjedhi dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga FEBZH, Universiteti Europian i Tiranës, bazuar në "Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017". Grupi i vlerësimit të jashtëm përbëhet nga Prof. Dr. Drini Salko dhe Dr. Andromahi Kufo. Detyra e ekspertëve të jashtëm ishte përpilimi i raportit të vlerësimit të jashtëm, mbështetur në shqyrtimin e dokumentacionit të përcjellë nga institucioni dhe gjetjeve gjatë kryerjes së vizitës në institucion. Grupi i punës u mbështet gjatë gjithë procesit të vlerësimit të jashtëm nga koordinatore të teknike të ASCAL, Msc. Arjana Alija.

Vzita në institucion u realizua në datën 11.05.2022 në mjediset e Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, të Universitetit Europian të Tiranës. Institucioni mbështeti vizitën e grupit të vlerësimit të jashtëm me të gjithë infrastrukturën e nevojshme gjatë vizitës në institucion. Dokumentacioni shtesë i kërkuar nga ekspertët u paraqit gjatë vizitës dhe u vu në dispozicion përmes sistemit AMS.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të institucionit dhe intervistave me pyetje të përcaktuara të ekspertëve për subjekte të caktuara, GVJ paraqet vlerësimin e tij sipas standardeve dhe për çdo kriter që i referohet standardit për programin e studimit Bachelor në "Financë" si më poshtë. Në fund të raportit është paraqitur analiza përfundimtare për programin e studimit që akreditohet dhe janë dhënë disa rekomandime për institucionin. Raporti është hartuar në bashkëpunim të ngushtë midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.



SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 127, datë 18/02/2016 janë:


Përmirësimi i shkallës së kualifikimit të titullarëve të lëndëve me zgjedhje të këtij programi studimi.

Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

Në plotësim të këtij rekomandimi dhe bazuar në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL", Departamenti përgjegjës ka riorganizuar profilet e Bachelor në Financë, duke i riorganizuar në katër profile me lëndë specifike sipas profilit. Kështu janë krijuar profilet: Bankë, Kontabilitet, Informatikë Ekonomike dhe Menaxhim Organizatash. Secili nga profilet ka pesë lëndë specifike, të cilat ofrohen nga titullarë së paku me PhD ose PhD kandidat, specifikisht:

	Nr i lëndëve sipas profilit	Nr. i Pedagogëve me titull Prof. Dr.	Nr. i Pedagogëve me titull Prof Assoc. Dr.	Nr. i Pedagogëve me titull Dr. Ose Phd	Nr. i Pedagogëve PhD kandidat	Nr. i Pedagogëve me Msc.
Profili Bankë	4	1	1	2	2	1
Profili Kontabilitet	4	0	1	1	2	2
Profili Informatikë Ekonomike	4	2				3
Profili Menaxhim Organizatash	4	2		2	1	1

Detajet e lëndëve dhe të emrave të pedagogëve janë paraqitur në lista brenda raportit të vlerësimit. Rekomandimi është plotësuar, gjithsesi ka vend për përmirësim në lidhje me lëndët që ofrohen nga kandidat për PhD, të cilët paraqiten si titullar të lëndës. Nr i pedagogëve me Msc ose kandidat PhD është në total 12 po aq sa edhe numri i pedagogëve me titull së paku PhD.



“Universiteti Europian i Tiranës” është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 30.09.2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 87/111 Prot, datë 30.09.2022. “Universiteti Europian i Tiranës” përcjell në ASCAL komentet përmes AMS dhe me anë të shkresës me Nr. 120/25 Prot., datë 12.10.2022, “Kthim përgjigje mbi draft raportin e vlerësimit të jashtëm”.

GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi Draft- Raportin, sqaron si vijon:

GVJ në FUSHA I-Standardi I.3.Kriteri 2

Vlerësimi i ekspertëve:

Kriteri 2

UET si institucion aplikues për riorganizimin e programit Bachelor në Financë dhe Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit si njësia kryesore e programit kane kryer një studim tregu në funksion të riorganizimit të programit. Nga shqyrtimi i studimit të tregut të realizuar vërejmë që në të janë vlerësuar qarte dy drejtimet kryesore:


a. Vlerësimi në bazë të kërkesës nga studentet potencial për të vazhduar këtë program. Rezultatet e vlerësimit të cilat bazohen në statistika krahasuese të kërkesave për këtë program me programe të institucioneve të tjera (institucione të Arsimit të Lartë jopublik) tregojnë se kërkesa për regjistrim për vitin 2021 ka qene pothuajse 4 fish e kuotës së caktuar.

b. Karriera dhe punësimi i studenteve të diplomuar. në këtë seksion të studimit të tregut jepen mundësitë e punësimit të diplomuarve në këtë program në mënyre të detajuar. Gjate 4 viteve të marra në studim (2016-2020) evidentohet që punësimi i studenteve që janë diplomuar në programin Bachelor në Finance ka qene në kufijtë 12% deri 27% .

Megjithatë duhet të theksojmë se studimi nuk trajton aspektin e ofertës në tregun e punës në fushën e financës dhe sidomos për 4 profilet e përcaktuara në te, gjë që do të plotësonte dhe argumentonte me mire riorganizimin e këtij program me profile.

Komente nga GVB: Në radhë të parë saktësojmë se programi nuk është riorganizuar. Ai vetëm është përshtatur me ndryshimet që pësoi legjislati në vitin 2015, dhe në përputhje me aktet nënligjore që u miratuan në 2018, specifikisht VKM Nr. 41, datë 24.01.2018. Departamenti vendosi të gruponte lëndët me zgjedhje të ofruara në kuadër të kategorisë C të programit në formën e profileve të studimit. Ndryshimet u miratuan në Senatit Akademik dhe u njoftua MAS, konform përcaktimeve ligjore.

Studimi i tregut që është në DVV nuk është studim i bërë përpara riorganizimit të programit, por një studim periodik që Departamenti e kryen për të analizuar kërkesat e tregut të punës në vazhdimësi. Evidencat tregojnë se kërkesa e studentëve për të studiuar në UET është rreth 4 herë më e lartë se kapaciteti infrastrukturor i institucionit për akomodimin e këtyre studentëve. Duke qenë se profilet në rastin e programit Bachelor, nuk janë veçse grup lëndë me zgjedhje, të orientuara në një nëndisiplinë të caktuar, nuk është parë me interes që analiza të bëhet në nivel profili. Departamenti analizoi periudhën 3 vjeçare të ofrimit të programit me profile dhe profilet që nuk rezultuan atraktive për studentët u vendos të mbylleshin, konkretisht profili Sigurime dhe Menaxhim i Organizatave (Vendimi i Senatit Nr. 11, datë 26.03.2021).



Nisur nga fakti që oferta diferencohet nga cilësia, nuk ka qënë në objektin e studimit të tregut analiza e ofertës në nivel kombëtar, përse kohë në nivel institucional kërkesa tejkalon ofertën (numrin e kuotave) që ka shpalluar Universiteti European i Tiranës për programin e ciklit të parë të studimeve, Bachelor në “Financë”.

Komente nga GVJ: Për sa më sipër saktësojmë në raportin tonë të vleresimit që aplikimi i referohet riakreditimit për këtë program dhe nuk është riorganizim, proces që është miratuar që në vitin 2018. Lidhur me kërkesat e këtij kriteri në raportin e GVJ janë evidentuar të dyja komentet e GVB lidhur me kërkesat e larta për këtë program dhe mundësitë e punësimit të të diplomuarve. Por, institucionit në studimin e tregut nuk ka mundur të jap qartë dhe të analizojë ofertën e tregut të punës, ecurinë dhe perspektiven e këtij tregu në fushën e financës me qëllim punësimin sa më të lartë të të diplomuarve në sektorin financiar

Vleresimi i kriterit nuk ndryshon

GVJ në FUSHA II-Standardi II.1.Kriteri 4

Vleresimi i ekspertëve:

Kriteri 4

Programi i studimit ofron njohuri të avancuara në fushën teorike shkencore, por dhe të natyrës aplikative në fushën specifike të financës, bankës, kontabilitetit, informatikës ekonomike dhe menaxhimit të organizatave. E rëndësishme është që në këtë program arrihen të koordinohen edhe njohuri baze të financës me ato të menaxhimit të riskut me njohuritë e kontabilitetit dhe informatike që “specializojnë” në një farë mase të diplomuarit në këtë program me profilet që ata përcaktojnë të përfundojnë studimin.


Megjithatë në funksion të hartimit sa më të plote të një programi studimi bachelor në Finance me 4 profilet e propozuara mendojmë se në program do të duhej që:

a. në kursin e parë të programit të studimit në semestrin e dytë do të duhej të përfshihet lënda “Kontabilitet Financiar” si një vijueshmëri logjike e lëndës “Parimet e Kontabilitetit që zhvillohet në semestrin e parë të këtij viti. Lënda “Kontabilitet kosto mund të kalojë në semestrin e parë të kursit të dytë.

b. Lënda “Metodat e kërkimit që është planifikuar të zhvillohet në semestër të dytë të Kursit të parë mund të kalojë në Kursin e dytë dhe të zëvendësohet me lëndën “Teori e Statistikës”. Kjo me logjiken që studenti të këtë marre njohuritë baze dhe aplikative të statistikës (“Teorinë e Statistikës dhe “Statistike e Aplikuar” kjo e fundit planifikuar të zhvillohet semestrin e dytë të kursit të dytë) dhe pastaj të zhvillojnë lëndën e Metodave të kërkimit ku padyshim njohuritë e statistikës janë të rëndësishme.

Komente nga GVB: GVB vlerëson komentet e ekspertëve të GVJ, të cilat sjellin një këndvështrim tjetër mbi strukturimin e kurrikulës së programit të ciklit të parë të studimeve, Bachelor në “Financë”, ndërsa informojmë si vijon:

Duke qënë se “Parimet e kontabilitetit” dhe “Kontabilitet kosto”, janë lëndë të formimit bazë dhe ofrohen respektivisht në vitin e parë, semestri i parë (“Parimet e kontabilitetit”) dhe vitit i parë, semestri i dytë (“Kontabilitet kosto”), programi përmbush varësinë ndërlëndore mes lëndëve. Ndërkohë lënda “Kontabilitet financiar” është menduar nga grupi i punës së hartimit



të programit (përshtatur në 2018) të klasifikohet si lëndë profili, për studentët që do të thellojnë studimet e tyre në gruplëndën (profilin) Kontabilitet.

Në fakt, programi i lëndës “Teori e statistikës” është mjaft i avancuar në raport me programin e lëndës “Metoda kërkimi” dhe në mënyrën si është hartuar silabusi, lënda “Teori e statistikës” është vazhdim i lëndës “Metoda kërkimi”. Në lëndën “Metoda kërkimi”, studenti merr njohuri bazë mbi pyetjen kërkimore, hipotezën, përcaktimin e variablave, metodologjisë kërkimore, sigurimit të të dhënave empirike, interpretimit të tyre dhe strukturimit të studimit. Në këtë mënyrë, lënda “Metoda kërkimi” është konceptuar në kuadrin e një lënde për formim të përgjithshëm e cila i ofrohet të gjitha programeve “Bachelor” në Universitetin Europian të Tiranës. Studentët e programit Bachelor në “Financë”, pasi kanë marrë njohuritë bazë në lëndën “Metoda kërkimi”, thellojnë më shumë njohuritë e tyre aplikative në lëndët “Teori e statistikës” dhe “Statistikë e aplikuar”.

Komente nga GVJ: Për sa më sipër saktësojmë se në vlerësimin tonë jemi bazuar në rrjedhen logjike të programit për lëndë të veçanta. Bazuar në faktin se lënda e vendosur në program “Kontabiliteti Financiar” konsiderohet si lëndë e profilit të Kontabilitetit, si dhe lënda “Metoda e Kerkimit” trajton njohuritë bazë në këtë fushë vleresojme të drejtë këtë renditje të lëndëve.

Komenti merret parasysh dhe GVJ ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA II-Standardi II.1.Kriteri 6

Vleresimi i ekspertëve:

Kriteri 6

Mbështetur në pasqyrën e hartuar nga institucioni “Plani mësimor i ndare sipas veprimtarive formuese” evidentojmë se organizimi i kurrikulës respekton kriteret e përcaktuara në VKM nr 41, date 25.01.2018 sipas tipit të veprimtarisë nga A tek E.

Megjithatë në funksion të hartimit sa më të plotë të një programi studimi bachelor në Finance dhe sidomos në marrjen e njohurive me specifike për 4 profilet e propozuara mendojmë se në program mund të beheshin ndryshimet e mëposhtme :

a. Në profilin “Banke” mund të përfshihet lënda “ Kontabilitet bankar” në vend të lendes Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit” për të marrë njohuritë specifike të kontabilitetit në këtë profil. Kjo nisur edhe nga fakti që bankat në Shqipëri prej shume vitesh i referohen këtyre standardeve të kontabilitetit.

b. Tek profili “Kontabilitet” në vend të lendes “Ekonomi dhe teknike bankare” mund të përfshihej përsëri lënda “Kontabiliteti bankar” duke e profilizuar me tej këtë zgjedhje të mundshme nga studentet.

c) Tek profili “Menaxhim i Organizatave” që mendojmë se është disi me larg drejtimit baze të këtij programi në “Finance” mund të përfshihej lënda “ Hyrje në menaxhim risku” me qellim që edhe ky profil të marre me shume njohuri të fushës se menaxhimit financiar.

Komente nga GVB: Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës në bashkëpunim me Dekanatin dhe përgjegjësit e gruplëndës, në kuadër të parimit të lirisë akademike, ka

zhvilluar një rivlerësim paraprak të programit dhe në profilin Kontabilitet, studentët në vend të lëndës “Ekonomi dhe Teknikë Bankare” do të zhvillojnë lëndën “Parimet e Auditimit” [bashkëlidhur Ref.Nr. 1. Propozimi i Departamentit, datë 22.06.2022]. Duke qënë se kurrikula nuk mund të ndryshonte në mes të vitit akademik, u vendos që ndryshimi të reflektohej në fillimin e vitit akademik 2022-2023. Profili “Menaxhim i Organizatave” me Vendimin e Senatit Akademik Nr.11, datë 26.03.2021 [bashkëlidhur, Ref.Nr. 2] nuk do të ofrohet për studentët që prej vitit akademik 2021-2022. Ky profil është përfshirë në akreditim, për efekt të diplomimit të studentëve që e kanë zgjedhur atë gjatë periudhës 2018-2020. [DVV-Ref.Nr. 29. Cilesia ne hyrje dhe dalje per programin].

Komente nga GVJ: Për sa më sipër saktësojmë se në vlerësimin tonë jemi bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të aplikimit të institucionit dhe në viziten e bërë pranë tij. Bazuar në dokumentacionin shtesë që institucioni ka sjellë (pas shqyrtimit te draft raportit te GVJ nga institucioni) vërejmë se profili “Menaxhim i organizatave” për të cilën e kemi vlerësuar si një profil larg fushës së finacës, me vendimin e Senatit Akademik të UET datë 26.03.2021 (referencë nr.2 në dokumentet shtesë) ka mbyllur këtë profil. Po ashtu edhe bazuar në rivlerësimin e programit dhe zëvendësimin e lëndës “Ekonomi dhe Teknike Bankare” me lëndën “Parimet e Auditimit” përmirësojnë më tej këtë program.

Komenti merret parasysh dhe GVJ ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA II-Standardi II.4.Kriteri 6

Vlerësimi i ekspertëve:

Kriteri 6

Nga shqyrtimi i përmbajtjes të lendeve të këtij program të prezantuar nga institucione vërejmë se në pothuaj shumicën e tyre ka përditësim të njohurive bazuar në literature detyruese dhe ndihmese të botuar gjate viteve të fundit. Edhe nga takimi me stafin e DEF gjate vizitës në institucion në evidentuam përditësimin e literaturës

Vërejmë që vetëm në lëndën e “ Drejta Bankare” nuk kemi një perditesim të literaturës se detyrueshme dhe deri diku edhe të asaj ndihmese. Gjithashtu program i lendes “Financa e Ndërmarrjes” i referohet si literature të detyrueshme përkthimit të tekstit “Bazat e Financës “ të autorit Mayo H në një kohe që tashme janë ofruar në treg përkthime nga autore të njohur të teksteve ndërkombëtare në Drejtëm Financiar, apo tekste tashme të konsoliduar të autoreve vendas me këtë emërtim.

Komente nga GVB: Teksti dhe programi i lëndës “Financat e Ndërmarrjes” është në proces rishikimi që prej tetorit të vitit 2021. Me datë 10/8/2021 është bërë nga DEF kërkesa për pasurimin e literaturës për lëndën “Financat e Ndërmarrjes” dhe gjatë vitit 2021-2022 teksti referencë i rasteve studimore të trajtuara ka qënë teksti i huaj, konform politikave të institucionit për përdorimin e literaturës së huaj nga shtëpi prestigjioze botimi. Studentëve u janë vënë në dispozicion raste studimore dhe materiale nga teksti “Corporate Finance” (Pearson 2017)

Komente nga GVJ: Në vlerësimin e tij GVJ është bazuar në shqyrtimin e programeve të paraqitura në aplikim duke evidentuar përmbajtjen e tyre. Instituzioni do të duhet të përmirësojë këto dy syllabuse krahas përditësimit të literaturës referuese në to.

Vlerësimi i kriterit nuk ndryshon

GVJ në FUSHA III – Standardi III.4 - Kriteri 3

Vlerësimi i ekspertëve:

Kriteri 3

DEF si njësi bazë dhe monitoruese e programit, nxit zhvillimin e metodave të reja mësimdhënëse nëpërmjet organizimit të leksioneve të hapura me personalitete të njohura të fushës së financës apo zhvillimin e lëndëve apo pjesë të saj nga profesorë të ftuar. ***Nuk u evidentua realizimi i këtyre metodave për studentët e këtij programi, por në kuadër institucional, UET ka mbështetur zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.***

Komente nga GVB: Gjejmë rastin të informojmë lidhur me këtë aspekt se, DEF ka zhvilluar gjatë vitit akademik 2021-2022, disa leksione të hapura me personalitete të fushës. Më poshtë përmenden disa prej tyre.

Bledar Shella, CEO i OTP Bank Albania

Spiro Brumbulli, Sekretar i Përgjithshëm i Shoqatës Shqiptare të Bankave

Amel Kovačević - Chief Executive Officer, United Bank of Albania

Adja Angjeli, Zv. Drejtore Biznesi në Credins Bank

Ilir Rudi CPA, CFE, MBA, Drejtor i Divizionit të Auditimit të Brendshëm, ABI Bank, Kryetar i Komitetit të Auditimit – Shoqata Shqiptare e Bankave

Sofika Nazaj, Keshilltare e Drejtorit të Përgjithshëm në Credins Bank

Iva Ikonomi (Zheku) – Head of Retail, Fibank

Roden Pajaj Drejtor i Përgjithshëm i Burimeve Njerëzore, Deloitte

Eni Çeço, Menaxhere për zhvillimin, Balfin

Prof. Gheorghita Dinca - Transilvania University of Braşov, Romania (Incoming Professor)

Vincenzo Carbon University of International Studies (UNINT) in Rome (Incoming Profesor)
[bashkëlidhur Ref.Nr. 4-11]

Komente nga GVJ: Për sa më sipër saktësojme se në vlerësimin tonë kemi bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të aplikimit të institucionit dhe në viziten e bërë pranë tij. Bazuar në dokumentacionin shtesë që institucioni ka sjellë (pas shqyrtimit të draft raportit të GVJ nga institucioni) vërejmë se janë zhvilluar leksione të hapura nga personalitete apo profesioniste të mirënjohur me studentet e këtij programi. (Referenca nr.4-11)

Komenti merret parasysh dhe GVJ ndryshon vlerësimin

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

GVJ në FUSHA III – Standardi III.7 - Kriteri 9

Vlerësimi i ekspertëve:

Kriteri 9

Nga takimi me studentët e programit GVJ evidentoi që mbështetja e studentëve konsiston në krijimin e klimës favorizuese dhe të përshtatshme për të realizuar detyrat e kursit. Kjo arrihet nëpërmjet kontakteve apo njohjeve që pedagogu i lëndës ka me drejtues institucionesh duke mundësuar angazhimin e tyre me studentët. ***Nga ana tjetër GVJ nuk evidentoi që studentët të këtij programi të kishin marrë mbështetje financiare në këtë drejtim.***

Komente nga GVB: Gjejmë rastin të informojmë se, lidhur me këtë aspekt, zhvillohen dy aktivitete të rëndësishme që lidhen me mbështetjen e studentëve për zhvillimin e ideve inovative:

Forumi i Studentëve të Financës, është një aktivitet që është zhvilluar për 10 vite rradhazi nga DEF. Studentët përgatisin një ese mbi një tematikë të paracaktuar. Prezanimet vlerësohen nga një komision me anëtarë të brendshëm dhe të jashtëm dhe studentët më të mirë, përftojnë çmim, i cili është në formën e vlerësimit financiar dhe internshipe.

Fituesit për vitin akademik 2021-2022, Gregora Lufta, Loren Zekaj, Loren Zekaj, Enton Lika, Arold Mastori, u vlerësuan duke u pajisur me një kartë të parapaguar dhe internship në Credins Bank [**bashkëlidhur Ref.Nr.12. Poster i aktivitetit**]. Po ashtu, çdo vit fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit organizon eventin, “Ideja më e mirë e biznesit”, ku studentët me idenë më inovatore, vlerësohen me mbështetje financiare,

Komente nga GVJ: Për sa më sipër saktësojmë se në raportin tone të vlerësimit për këtë kriter ne jemi bazuar në takimin e zhvilluar me studentët ku nuk u evidentua mbështetje financiare as edhe informacion që ata duhet të kishin rreth këtij procesi mbështetje financiare.

Vlerësimi i kriterit nuk ndryshon

GVJ në FUSHA IV – Standardi IV.6 - Kriteri 1 dhe 2

Vlerësimi i ekspertëve:

Kriteri 1

Vlerësimi i ekspertëve: “... GVJ mendon se një proces me gjithëpërfshirës ku edhe Departamentet dhe Rektorati/Senati të marrë pjesë në përcaktimin e nevojave dhe miratimin e tyre është i domosdoshëm, dhe/ose nëse ekziston të evidentohet me një procedurë specifike të hartimit të këtij plani financiar.”

Dhe

Kriteri 2

Vlerësimi i ekspertëve: “...GVJ mendon se hartimi i një plani financiar gjithëpërfshirës do të bëjë të mundur të analizoje të gjithë të ardhurat dhe shpenzimet sipas natyrës së tyre specifike.”

Komente nga GVB: Gjejmë rastin të informojmë në vijim se, përsa i përket aspektit të gjithëpërfshirjes së njësive për propozime në lidhje me planifikimin e buxhetit, ky proces është i sanksionuar në aktet rregullatore të UET dhe përfshin të gjithë njësitë përbërëse të UET, ndër to edhe departamentet. Bashkëlidhur disa evidenca në lidhje përfshirjen e Departamentit të Ekonomiksit dhe Financës në këtë proces. [DVV-Ref.Nr.6. F.V. Mbi organizimin dhe funksionimin e Departamentit, Pika F.V.4.6. Kompetencat administrative të Drejtuesit të Departamentit; bashkëlidhur Ref.Nr.3. Email blerje tekstesh].

Komente nga GVJ: Për sa më sipër GVJ konsideron se hartimi i procedurës është i ndryshem nga dokumenti i pvraktimit të funksionimit të Departamentit ku përshkruhen kompetencat e Departamentit. Me procedurë nënkuptohet një numër hapash të caktuar ku palët përfshihen në proces duke evidentuar nevojat e tyre dhe jo duke dhënë thjesht mendime. Evidenca e “email blerje tekstesh” është vetëm një pjesë e procesit të buxhetimit dhe jo një procedurë sic GVJ e ka konceptuar.

Vlerësimi i kriterit nuk ndryshon.

GVJ në FUSHA V – Standardi I.3 - Kriteri 2 -

Vlerësimi i ekspertëve: “Institucioni ka si praktikë përgatitjen e sillabuseve për secilën lëndë, të cilat çdo pedagog i vë në dispozicion të studentit në fillim të vitit akademik në auditor, por edhe në sistemin e komunikimit pedagog - student LMS. Syllabusi përfshin në mënyrë të detajuar përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të lëndës. GVJ sugjeron krijimin e një “prospectusi” për programin ku të përfshihen të gjitha lëndët e programit së bashku e të ofrohet si një dokument sqarues tek studentët.

Komente nga GVB: Informojmë se Universiteti Europian i Tiranës, harton çdo vit Broshurën informuese për programet e studimit dhe institucionin në përgjithësi, si edhe pasqyron informacion të detajuar për programin e studimit në faqen e internetit <https://uet.edu.al/wp-content/uploads/2021/11/BA-Finance-shqip.pdf> [bashkëlidhur Ref.Nr.14-16].

Komente nga GVJ: Për sa më sipër, u informuam dhe nga ana e IAL u paraqit dokumenti nr.14-16, dhe pdf e paraqitur në website, i cili përfshin programin e lëndeve, ndarjen e tyre sipa llojit të lëndës dhe ECTS të çdo lënde. GVJ me “prospectus nenkupton edhe përshkrimin e lëndëve përkatëse për studentët.

Vlerësimi i kriterit nuk ndryshon.

GVJ në FUSHA VI – Standardi VI.2 – Kriteri 5 dhe Standardi VI.5 – Kriteri 2,3 dhe 4

Vlerësimi i ekspertëve:

Standardi VI.2 – Kriteri 5 : “Raportet e vlerësimit përfshijnë analizën e arritjeve kundrejt objektivave dhe ndiqen nga KSBC për plotësimin e tyre. Sipas planit të KSBC përpilohet një raport vjetor, *por ky i fundit nuk është pjesë e dokumentacionit nga Institucioni. GVJ po ashtu vëren që një pjesë e dokumentacionit të Sigurimit të Cilësisë vjen si produkt i projektit QAINAL, por nuk është përshtatur/ndërlidhur me dokumentacionet që Institucioni përdor, duke i lënë të shpërndara informacionet nga relacione të veçanta.*

Një praktikë e një analize ankese nga studentët është vënë në dispozicion nga dokumentacioni shtesë.

[Evidenca shtesë nr. 4. Praktikë e analizimit të ankesave të studentëve - evidencat.pdf]

Standardi VI.5 – Kriteri 2 : “Institucioni nuk i publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit në faqen e internetit apo të intranetit të tij, për arsye siç përmenden sensitive dhe personale. Nga takimi me GVJ u përmend që këto raporte i disponoheshin autoriteteve drejtuese të UET dhe pedagogëve në mënyrë të personalizuar. As në dokumentacionin e disponuar për akreditim ekspertët nuk u ndeshën me raportin vjetor të KSBC, për të gjykuar në lidhje me cilësinë e programit dhe zbatimin e sistemit monitorues të ngritur në bazë të strategjisë dhe politikave të UET.”

Standardi VI.5 – Kriteri 3 : “Në mungesë të rezultateve të vlerësimit, GVJ ka vënë re se KSBC ka një plan me objektivat të përcaktuara për të gjithë fushat e vlerësimit, të përcaktuar me instrument dhe raporte në lidhje me to. Nuk është evidentuar një raport final edhe nga KSBC në lidhje me plotësimin e këtyre planeve.”


Standardi VI.5 – Kriteri 4 : “Përdorimi i disa instrumentave në funksion të sigurimit të cilësisë dëshmon se institucioni vlerëson këtë proces maksimalisht. GVJ vlerëson se Institucioni duhet të investojë më shumë në implementimin dhe efikasitetin e metodave në rritje të cilësisë.”

Komente nga GVB: Kontrollat të cilat realizohen nga KSBC dhe kanë të bëjnë me monitorimin e aktiviteteve të cilat garantojnë sigurimin e cilësisë përmes vlerësimit të nivelit të përmbushjes së standardeve të përcaktuara në aktet rregullatore të Universitetit dhe vlerësimin e efikasitetit të sistemit të brendshëm të sigurisë. Sikurse është bërë e ditur gjatë fazave të procesit të akreditimit, rezultatet e kontroleve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programet në kuadër të përmirësimit të tyre dhe praktikave që lidhen me aktivitete të stafit akademik.

Dokumentimi bëhet në formën e raporteve Institucionale, ku për çdo njësi paraqiten gjetjet përkatëse. Gjetjet e përgjithshme dhe gjetjet respektive për çdo departament/njësi, janë drejtimit ku duhet të bazohet më tej puna e Departamentit/Universitetit për të nxitur praktikën e mira apo për të bërë përmirësimet e nevojshme.

Informojmë GVJ se në kuadër të transparencës dhe informimit të publikut, Universiteti publikon në website e tij raportet e vlerësimit të brendshëm të departamenteve dhe raportet e vlerësimit të jashtëm të ekspertëve të vlerësimit (<https://uet.edu.al/raporte-vleresimi/>). Gjithashtu, raportet vjetore të aktivitetit të UET i bëhen me dije Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.



Bashkëlidhur;



- a) Raporti i vlerësimit përmes focus grupeve (bashkëlidhur njoftimi i studentëve për zhvillimin e focus grupeve, shpërndarja e raportit në nivelet drejtuese të Universitetit/Fakultetit/Departamentit dhe ekstrakt i raportit final të focus grupeve), Nr. Ref. 17.1 / 17.2/ 17.3/ 17.4;
- b) Vlerësimin e procesit të realizimit të provimeve Ref. Nr. 18: Ekstrakt – Raporti i Kontrollit të Provimeve_2021-2022.

Komente nga GVJ: GVJ ka riparë dokumentacionin e dërguar nga institucioni dhe ka evidentuar publikimin e raporteve të vetvlerësimit për programet dhe për institucionin në website të universitetit. GVJ i referohet në kriteret e veta raportit të Njesisë së brendshme të universitetit në lidhje me sigurinë e cilësisë dhe jo raporteve të akreditimit. Po ashtu i referohet një analize të cilësisë në nivel Departamenti ose programi në trajtën e gjetjeve dhe masave të mara, të cilat nga ekstraktet e dërguara nuk evidentohen. GVJ ngelet në mendimin e tij se “përdorimi i disa instrumentave në funksion të sigurimit të cilësisë dëshmon se institucioni vlerëson këtë proces maksimalisht. GVJ vlerëson se Institucioni duhet të investojë më shumë në implementimin dhe efikasitetin e metodave në rritje të cilësisë” dhe veçanërisht në monitorimin me raporte specifike në lidhje me cilësinë.

Vlerësimi i kriterit nuk ndryshon.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Financë” me profile.

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE


Standardi I.1				
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Financë” me profile që ofrohet nga Universiteti European i Tiranës (UET) nuk bie ndesh me interesa kombëtare. në këtë faze riorganizimi që kërkohet merren parasysh edhe zhvillimet ekonomiko sociale dhe kërkesat e tregut të punës në funksion të interesave kombëtare . <i>(Shqyrtimi i dokumentet bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.2; 3; 3.1 dhe 3.2 ; 3.3 dhe nr.14)</i>			
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Ky program studimi ruan dhe konsolidon me tej vlerat akademike e kulturore të vendit si dhe interesi kombëtare. <i>(Shqyrtimi i dokumentet bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.2; 3; 3.1 dhe 3.2 ; 3.3 dhe nr.14)</i>			
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Ky program në këtë faze riorganizimi bazohet në përputhje me qëllimin dhe misionin e UET dhe fushën e veprimtarisë se tij. Këtë e bazojmë mbështetur në shqyrtimin dokumentacionit themelore të institucionit si statutin, strategjie e hartuar nga institucioni dhe kuadrin rregullator të tij. <i>(Shqyrtimi i dokumentet bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.2; 3; 3.1 dhe 3.2 ; 3.3 dhe nr.14)</i>			
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Programi i studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Financë” me profile që ofrohet nga Universiteti European i Tiranës (UET) mban parasysh ecurinë e zhvillimit ekonomik lokal e kombëtar të vendit sidomos në sektorin financiar të ekonomisë. <i>(Shqyrtimi i dokumentet bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.2; 3; 3.1 dhe 3.2 ; 3.3 dhe nr.14)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Programi i studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Financë” me profile që ofrohet nga UET është bazuar në dokumentet themelore të zhvillimit institucional. Ky program është në funksion të zbatimit të Vizionit, prioriteteve dhe objektivave të vendosura në Strategjinë institucionale të periudhës 2021-2025 si dhe të strategjisë se vete programit të paraqitur nga institucioni. Kështu, mund të përmendim objektivin strategjik 1.2 në të cilin theksohet rritja si e nr të studenteve

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	ashtu edhe konsolidimi dhe funksionimi i programeve ekzistuese dhe programeve të reja studimore. (Shqyrtimi i dokumentet bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.2; 3; 3.1 dhe 3.2 ; 3.3 dhe nr.14)			
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Ky program bazohet para se gjithash në statutin dhe rregulloren e institucionit në të cilat janë përcaktuar direktivat e zhvillimit dhe prioritetet akademike të tij (neni 6 dhe 7 i statutit). në funksion të këtyre dy dokumenteve themelor është hartuar edhe rregullorja mësimore e vete programit Bachelor në “Finance” me profile ku në piken 3.1.2. të saj theksohet mundësia e profilizimit përmes zgjidhjes se grup lendeve të kategorisë C. Gjithashtu në planin strategjik për zhvillimin e programit të studimit Bachelor në Finance hartuar nga Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës që mbulon këtë program janë me të plota dhe të detajuara fushat akademike e drejtimit të tij (Shqyrtimi i dokumentet bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.2; 3; 3.1 dhe 3.2 ; 3.3; 5 dhe nr.14)			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Bazuar në përmbajtjen dhe strukturën e programit bachelor në “Finance” me profile konkludojmë se ai bazohet në kriteret e përcaktuara në aktet ligjore, nënligjore dhe rregullative në fuqi. Emërtimi, organizimi dhe struktura dhe përmbajtja e tij përfshijnë fushën e Financës si një nder fushat e ekonomisë të përcaktuar në drejtimit kryesore të zhvillimit të institucionit. (Shqyrtimi i dokumentet bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.2; 3; 3.1 dhe 3.2 ; 3.3 ; 5 dhe nr.14)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	Riorganizimi i programit Bachelor në “Finance “ me profile bazohet në objektiva të përcaktuara qarte për formimin e studenteve që përfshijë dijet teorik shkencore me ato praktike në funksion edhe të profilizimit të tyre. (Shqyrtimi i dokumentet bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.4;)
Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të	UET si institucion aplikues për riakreditim te programit Bachelor në Finance dhe Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit si njësi kryesore e programit kane kryer një studim tregu në funksion të riorganizimit të programit. Nga shqyrtimi i studimit të tregut të realizuar vërejmë që në të janë vlerësuar qarte dy drejtimit kryesore:

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>a. Vlerësimi në baze të kërkesës nga studentet potencial për të vazhduar këtë program. Rezultatet e vlerësimit të cilat bazohen në statistika krahasuese të kërkesave për këtë program me programe të institucioneve të tjera (institucione të Arsimit të Lartë jopublik) tregojnë se kërkesa për regjistrim për vitin 2021 ka qene pothuajse 4 fish e kuotës se caktuar.</p> <p>b. Karriera dhe punësimi i studenteve të diplomuar. Në këtë seksion të studimit të tregut jepen mundësitë e punësimit të diplomuarve në këtë program në mënyre të detajuar. Gjate 4 viteve të marra në studim (2016-2020) evidentohet që punësimi i studenteve që janë diplomuar në programin Bachelor në Finance ka qene në kufijtë 12% deri 27% .</p> <p>Megjithatë duhet të theksojmë se studimi nuk trajton aspektin e ofertës në tregun e punës në fushën e financës dhe sidomos për 4 profilet e përcaktuara në te, gjë që do të plotësonte dhe argumentonte me mire riorganizimin e këtij program me profile. (Shqyrtimi i dokumentet bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.12. 12.2 dhe nr.17)</p>			
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Finance i riorganizuar me profile ka të përcaktuar qarte objektivat formuese dhe strukturën përkatëse. Gjithashtu përmbajtja e programit të studimit përfshin njohuritë teorike praktike në fushën e Financës duke garantuar që dijet e marra u përgjigjen nevojave të tregut të punës kryesisht në fushën e finance bankës.</p> <p>(Shqyrtimi i dokumentet bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.12. 12.2 ; nr.14 dhe 14.1)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi I.4 Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Finance” tashme ka një historik relativisht të gjate duke filluar që me akreditimin e pare në vitin 2009 dhe të fundit në vitin 2016. Bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni vërejmë se ky i fundit ka gjithë kapacitetin e duhur akademik për ofrimin e këtij program në fushën e Financës. Edhe plotësimi i mangësive të vërejtura nga akreditimi i mëparshëm lidhur me plotësimin e stafit tashme është plotësuar.</p> <p>(Shqyrtimi i dokumentet bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr 0.1; 0.2 ; nr 26 ; nr..54.1; 54.2; 54.3.2 ; dhe nr.54.4)</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit është njësia kryesore e këtij programi studimi që përfshin krahas fushave të tjera të ekonomisë edhe fushën e Financës dhe 4 profileve të ofruara nga ky</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


<p>akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>program duke qene në përputhje me direktivat dhe udhëzimet kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>(Shqyrtimi i dokumentet bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr26 ; nr..54.1; 54.2; 54.3.2 ; dhe nr.54.4)</p>			
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Finance” me profile përfshihet brenda fushës akademike dhe kërkimore të Departamentit të Ekonomiksit dhe Financës që është dhe njësia baze e këtij program. Kjo njësi me eksperience shume vjeçare mbulon fushën akademike të Financës që është dhe baze e këtij program. Kjo njësi përbehet nga 17 anëtare që janë personel akademik me kohe të plote .</p> <p>(Shqyrtimi i dokumentet bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.01; 02 ;nr26 ; nr..54.1; 54.2; 54.3.2 ; dhe nr.54.4)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.5 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Marrëdhëniet e bashkëpunimit brenda UET dhe ndarja e detyrave dhe përgjegjësisë mes njësisë kryesore, njësisë baze dhe gjithë strukturave mbështetëse të programit janë të sanksionuar në një sere aktesh rregullative dhe mbikëqyrëse si rregullore e UET, rregullore e programit të studimit Bachelor në Finance si dhe dokumenti “Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit. Po ashtu dhe dokumenti mbi funksionimin e sekretarisë mësimore përcakton rolin e saj në funksion të mbarëvajtjes se programit. në këto dokumente janë të përcaktuar qarte drejtimit e bashkëpunimit dhe ndarja e përgjegjësisë të gjitha njësisë përkatëse.</p> <p>(Shqyrtimi i dokumentet bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.5; 7 dhe dokumentet nr ,FIV,FV dhe nr.9)</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Në funksion të realizimit të objektivave mësimore dhe formuese të studenteve UET ka nënshkruar një nume të larte marrëveshje bashkëpunimi me 94 institucione homologe jashtë vendit , 15 institucione homologe brenda vendit si dhe me 47 aktore të biznesit si një kompletim i projektit 500 + që funksionon prej vitesh. në funksion të programit bachelor në Financë janë realizuar marrëveshje bashkëpunimi me një numër institucionesh financiare (</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	banka dhe shoqëri siguri) të cilat përbejnë dhe pjesën me të madhe të tregut të punës në këtë fushë. (Shqyrtimi i dokumentet bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.12.4; 34; 34.1 dhe 35)								
Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës si njësi bazë dhe përgjegjëse e këtij program evidenton nëpërmjet raporteve periodike përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit që ka institucioni me të tretet në evidentuam në raportin periodik të prezantuar në aplikim ku trajtoheshin rezultatet e bashkëpunimit nëpërmjet të dhënave të shkëmbimeve të studenteve dhe stafëve në kuadër të marrëveshjeve me institucione homologe jashtë vendit, realizimin e intershipeve dhe praktikave profesionale të studenteve pranë institucioneve dhe bizneseve vendase si dhe rezultatet e panairit të punës që organizon institucioni. (Shqyrtimi i dokumentet bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr. 35)								
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm shqyrton marrëveshjet e bashkëpunimit të përmendura me lart që UET ka me institucione dhe biznese vendase dhe evidentoi se në to përfshihet klauzola e realizimit të praktikave mësimore për studentet e këtij institucioni. Gjithashtu u evidentua edhe lista e stafit akademik përgjegjës për ndjekjen e realizimit të këtyre praktikave. (Shqyrtimi i dokumentet bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.12.4; 34; 34.1 dhe 35)								
Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit evidentohet realizimi në auditor i temave trajnuese nga specialist të institucioneve apo bizneseve vendas që japin eksperiencën e tyre duke angazhuar studentet në realizimin e projekteve lidhur me to. Nuk evidentuam trajnime të mirëfillta profesionale për studentet e diplomuar. (Shqyrtimi i dokumentet bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.; 34.1 dhe 35)								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit	Programi i studimit Bachelor në "Finance " i riorganizuar në 4 profilet


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>e tij:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <i>Banke</i> ➤ <i>Kontabilitet</i> ➤ <i>Informatikë Ekonomike</i> dhe ➤ <i>Menaxhimi i Organizatave</i> <p>dhe që ofrohet nga Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës i Fakultetit të Ekonomisë Biznesit dhe Zhvillimit pranë UET është i organizuar në lende e module të cilat vlerësohen me kredite përkatëse në përputhje me VKM Nr. 41, datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, ku lëndët e modulet vlerësohen me sistemin e krediteve ECTS dhe orë. Programi bazohet në Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ETCS) dhe parimeve të Kartës së Bolonjes. Programi me një kohëzgjatje 3 vite akademike e ndare në 6 semestra dhe që përfshin 181 ECTS. Ky program është akredituar për here të pare në vitin 2009 dhe për here të dyte në vitin 2016. (<i>Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr. 14 ;nr.14.1 ; dhe nr.14.2)</i>)</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.</p>	<p>Duke shqyrtuar programin mësimor si dhe përmbajtjen e syllabuseve konstatohet që arrihet të transmetohen njohuri të fushës së financës, bankës, kontabilitetit, informatikës ekonomike dhe deri diku menaxhimit të organizatave. Kjo bën të mundur që studentët që përfundojnë këtë program mund të punësohen si specialistë në banke, institucione të tjera, zyra kontabiliteti etje, por edhe të mund të vazhdojnë programin e ciklit të dyte në profilet e këtij programi pas diplomimit të tyre. (<i>Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr. 14 ;nr.14.1 ; dhe nr.14.2)</i>)</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Finance me 4 profilet ofron njohuritë bashkëkohore si në lendet e formimit baze (rreth 20 % programit) ashtu edhe në lendet karakterizuese të tij (afro 55 % e programit) dhe lendet ndërdisiplinore/integruese (afro 15% e programit). (<i>Shqyrtimi i dokumentave bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr. 14 ;nr.14.1 ; nr.14.2 ; nr.19 dhe nr.39)</i>)</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit ofron njohuri të avancuara në fushën teorike shkencore, por dhe të natyrës aplikative në fushën specifike të financës, bankës, kontabilitetit, informatikës ekonomike dhe menaxhimit të organizatave. E rëndësishme është që në këtë program arrihen të koordinohen edhe njohuri baze të financës me ato të menaxhimit të riskut me njohuritë e kontabilitetit dhe informatike që “specializojnë” në një farë mase të diplomuarit në këtë program me profilet që ata përcaktojnë të përfundojnë studimin. (<i>Shqyrtimi i dokumentave bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr. 14 ;nr.14.1 ; nr.14.2 ; nr.19 dhe nr.39)</i>)</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë</p>	<p>Nga shqyrtimi i këtij programi studimi rezulton se ai përfshin të gjithë elementët strukturor të përcaktuara në aktet ligjore, nënligjore dhe rregullative që kanë objekt arsimin e lartë në Shqipëri, të tilla si numri i</p>



strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	krediteve, kohëzgjatja e tij, sistemi i vlerësimit me kredite, kategorizimi i lëndëve, praktika profesionale, diplomimi etj. (Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr. 14 ;nr.14.1 ; nr.14.2 ; nr.19 dhe nr.39)			
Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Mbështetur në pasqyrën e hartuar nga institucioni “Plani mësimor i ndare sipas veprimtarive formuese” evidentojmë se organizimi i kurrikules respekton kriteret e përcaktuara në VKM nr 41, date 25.01.2018 sipas tipit të veprimtarisë nga A tek E. Bazuar në dokumentacionin shtesë të derguar nga institucioni pas shqyrtimit prej tij të draft raportit të GVJ për të tre profilet e programit (pasi profili “Menaxhim i organizatave” është mbyllur me vendim Senati të UET) kemi një grupim të plote dhe të qartë të lëndëve sipas veprimtarisë formuese të tyre. (Shqyrtimi i dokumentave bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr. 14 ;nr.14.1 ; nr.14.2 , nr.19, si dhe reference 1 dhe 2 te dokumentacionit shtesë derguar nga institucioni bashkë me komentet e draft raportit)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	UET, në funksion të përmbushjes së misionit dhe objektivave si Institucion i Arsimit të Lartë Jo Publik, është i organizuar dhe i përbërë me një strukturë hierarkike të tillë që të përmbushë dhe objektivat e programit të studimit Bachelor në Finance me profile. Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit si njësi kryesore e këtij programi dhe Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës si njësi bazë që mbulon zhvillimin e këtij programi, përmbushin kriteret ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi. (Shqyrtimi i dokumentave bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr. 23; 24; 25 dhe nr26)
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.	Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit si njësi kryesore e këtij programi ka miratuar me Vendim nr.93.12.2018 koordinorin e këtij programi bazuar në propozimin e Departamentit të Ekonomiksit dhe Financës duke përcaktuar edhe detyrat dhe përgjegjësit e tij. (Shqyrtimi i dokumentave bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr. 36) (Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr. 23; 24; 25 dhe nr26)
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e	Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit si njësi kryesore, aktualisht ka në përbërjen e tij 2 departamente dhe 1 qendër kërkimore :

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut Qendra për Zhvillimin e Qëndrueshëm (Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr. 23; 24; 25 dhe nr26)			
Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.	Njësia kryesore (FEBZH) në vitin akademik 2020-2021 ka të angazhuar në mësimdhënie 31 anëtare me kohe të plote nga të cilët 7 zotërojnë titullin akademik Profesor.Dr dhe 10 zotërojnë gradën Doktor. Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës, si njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi, në vitin akademik 2021-2022 , ka në total 18 staf akademik, prej të cilëve 17 janë PAE, me kualifikimin: 1 Prof.Dr., 3 Prof.Asoc; As., 4 Dr., dhe 3 Dr., në proces., 6 Msc lektor dhe vetëm një PAK si auditues ligjor, duke përmbushur kështu detyrimin ligjor dhe nënligjor për organizimin dhe strukturën akademike. (Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.20 . 23; 24; 25 dhe nr26)			
Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Njësia kryesore (FEBZH) dhe ajo baze (DEF) përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Njësia kryesore ka tre njësi baze dhe kjo e fundit (DEF) bulon 5 programe studimore. (Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr. 23; 24; 25 dhe nr26)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të prezantuar nga FEBZH dhe DEF dhe nga verifikimi gjatë vizitës në institucion, rezulton se këto njësi disponojnë informacionin e nevojshëm mbi organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit dhe jo vetëm si evidencë, por dhe të bërë publike në website e UET. (Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.7)
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Ky program studimi përmban të gjithë elementët e përcaktuar në Ligjin 80/2015 dhe VKM Nr.41, datë 24.01.2018. i ndryshuar. PS organizohet ne lende module te cilat percaktohen te zhvillohen sipas nje plani kalendarik te vleresuara ne sistemin ECTS me ore javore ne auditor dhe pune te pavarur dhe me nje shperndarje uniferme sipas semestrave. PS ka te percaktuar praktiken profesionale si komponent te programit. Zhvillimi i lendeve/moduleve te PS ndjek logjiken e formimit baze dhe ate profesionale. (Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr. 14; 14.2 dhe 14.1)
Kriteri 3. Programet e	Programi përfshin një numër total prej 181 ECTS dhe është i ndarë në



Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>strukturë në orë në auditor, orë në aktivitete të tjera si projekte, orë studimi individual, elementë këto matës të sistemit ECTS. Ngarkesa mësimore prej 1808 orësh është e ndarë në mënyrë pothuajse të barabartë në gjashtë semestrat e vitit akademik.</p> <p>Sugjerimet e mësipërme të GVJ mbi ndryshimet/ spostime për lëndë të veçanta në këtë program i shërbejnë përmirësimit të tij në procesin e vlerësimit të programit dhe lirisë akademike.</p> <p><i>(Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr. 14 ;nr.14.1 ; nr.14.2 dhe nr.19)</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/ jashtë auditorit, frekuentimin/ ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programit të studimit vërehet se ai jep të gjithë informacionin e nevojshëm me elementet përkatës; ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë tij, ndjekjen e programit (me kohë te plotë) si dhe vlerësimin e dijeve.</p> <p><i>(Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr. 14 ;nr.14.1 ; nr.14.2 dhe nr.19)</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Studentët kandidatë për tu regjistruar në këtë program si dhe ata që vazhdojnë procesin mësimor marrin informacion mbi kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullores së studimeve të UET • Rregullores së FEBZH së • Rregullores së programit në Finance <p>Studentët, në fillim të secilit semestër, informohen gjerësisht dhe pajisen me programin e lëndëve, ku jepen në detaje temat e lëndës, literatura kryesore, forma e kontrollit të dijeve, literatura e rekomanduar, etj.</p> <p>Ky informacion tashmë është edhe elektronikisht në faqen zyrtare të UET ku çdo student sheh gjithë materialet e lëndës që pedagogët vendosin në portal, krahas syllabusit.</p> <p><i>(Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr. 5; 7; 14 ;nr.14.1 ; nr.14.2 dhe nr.47)</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programit të studimit rezulton se ai përfshin gjithë elementët përbërës formues teorik praktik për një program të nivelit Bachelor. Nga shqyrtimi i syllabuseve vërehet se ato hartohen në gjuhë shqipe dhe përmbajnë të gjithë elementët e përcaktuara në Vendimin e KM Nr.41, datë 24.01.2018, i ndryshuar, si :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Emërtimi i lëndës/modulit • Viti/semestri kur zhvillohet lënda • Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën • Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit • Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetimin e lëndës • Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë • Temat që do të trajtojnë lënda në formimin teorik dhe praktik • Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS

	<ul style="list-style-type: none"> • Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre • Format e vlerësimit të studentëve • Detyrimet e studentit për lëndën • Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse <p>GVJ vlerësoi cilësinë e syllabuseve të programit të prezantuar në kuadër të këtij vlerësimi. Hartimi i syllabuseve të programit përfshin të gjitha elementët e nevojshëm duke plotësuar kriteret për to.</p> <p>Nga verifikimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion rezulton kontroll periodik i njohurive të marra me anë të testeve apo provimit përfundimtar. Format e mësimdhënies janë nëpërmjet vlerësimit periodik në seminare (për pjesëmarrje aktive), detyra kursi, provime të ndërmjetme dhe provim final. Përkatësisht, studenti vlerësohet gjatë vitit deri në 40-50 % (detyra kursi dhe provim i ndërmjetëm) dhe 50 -60 % në provimin përfundimtar.</p> <p>(<i>Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr. 14 ;nr.14.1 ; nr.14.2 dhe nr.19)</i></p>								
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	<p>Nga takimi me stafin akademik që mbulon këtë program si dhe me stafin e DEF u evidentua diskutimi dhe axhustimi programit në mënyre periodike (në fillim të vitit) brenda lirisë akademike si dhe futjen e informacioneve të reja të njohurive përkatës.</p> <p>(<i>Diskutime nga takimi me stafin gjatë vizitës në institucion</i>)</p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	<p>Ky program studimi plotëson kërkesat ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ai realizohet me një ngarkesë mësimore, shkencore dhe praktike me 181 ECTS dhe me afat kohor tre vite akademike.</p> <p>(<i>Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr. 14 ;nr.14.1 ; nr.14.2</i>)</p>
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	<p>Programi në përmbajtjen e tij ofron tiparet e një programi të nivelit të parë në fushën e Financës me profile. Programi kombinon njohuritë teorike në këtë fushë me ato praktike. Këtë e shikojmë në përmbajtjen e lëndëve të programit si dhe në realizimin e praktikës profesionale me mundësi punësimi në këtë treg specifik të punës kryesisht të sektorit financiar e bankar.</p> <p><i>Siç e kemi theksuar edhe me lart profili "Menaxhimi i Organizatave" është disi larg fushës së financës dhe do kërkonte me shume lëndë</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p><i>specifike që lidhin financën me menaxhimin e këtyre organizatave.</i> (Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr. 14 ;nr.14.1 ; nr.14.2 dhe nr.19)</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional.</p>	<p>Programi arrin të pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme në fushën e financës me 4 profilet. Programi synon që të rrisë edhe kompetencat profesionale të studentëve me fokus rritjen e aftësive aplikative që përfshijnë fushën e programimit financiar.</p> <p>Mbështetur në lëndët që ofron programi, por edhe në praktikën profesionale të përfshirë në të, ai arrin të ketë objektiv formimin teorik shkencor dhe relativisht edhe atë aplikativ të studentëve.</p> <p>(Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr. 14 ;nr.14.1 ; nr.14.2 dhe nr.19)</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Programi në hartimin dhe zhvillimin e tij bazohet në eksperiencat bashkëkohore Europiane dhe të vendit, si edhe duke vlerësuar nevojat e tregut të punës .</p> <p>Mbështetur në strukturën e programit, në lëndët që përfshihen në të, raportet teorike praktike, ky program përputhet me fushën e zgjedhur që është ajo financiare e bankar. Në të arrihet të trajtohen elementët e nevojshëm që lehtësojnë njohjen dhe ekuivalentimin e diplomës jashtë vendit, për qëllim vazhdimin e studimeve në ciklin e dyte apo punësimin e studentit. Programi i studimit është në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p> <p>(Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr. 14 ;nr.14.1 ; nr.14.2 dhe nr.19)</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit harmonizon përmbajtjen teorike me atë praktike. Nga shqyrtimi i syllabusve të lendeve karakterizuese të programit shohim që në to nja pjese të temave u referohen rasteve studimore apo praktikave laboratorike. Përmbajtja e tyre është e bazuar në përmbajtjen e lendeve të tilla edhe në universitetet e huaja duke mundësuar ekuivalentimin në rast transferim studimi.</p> <p>(Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr. 14 ;nr.14.1 ; nr.14.2 dhe nr.19)</p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i përmbajtjes të lendeve të këtij program të prezantuar nga institucione vërejmë se në pothuaj shumicën e tyre ka përditësim të njohurive bazuar në literature detyruese dhe ndihmëse të botuar gjate viteve të fundit. Edhe nga takimi me stafin e DEF gjate vizitës në institucion në evidencuam përditësimin e literaturës</p> <p><i>Vërejmë që vetëm në lënden e “ Drejta Bankare” nuk kemi një përditësim të literaturës se detyrueshme dhe deri diku edhe të asaj ndihmëse. Gjithashtu program i lendes “Financa e Ndërmarrjes” i referohet si literature të detyrueshme përkthimit të tekstit “Bazat e Financës “ të autorit Mayo H në një kohe që tashme janë ofruar në treg përkthime nga autore të njohur të teksteve ndërkombëtare në Drejtim Financiar, apo tekste tashme të konsoliduar të autoreve vendas me këtë emërtim.</i></p> <p>(Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr. 14 ;nr.14.1 ; nr.14.2 dhe nr.19)</p>



<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Përmbajtja e programeve realizon përfitimet e dijeve dhe aftësive të studenteve për një program bachelor në Finance. PS përfshin trajtimin fillimisht të lendeve baze me formim mikro dhe makroekonomik dhe që në vitin e parë përfshihen lëndet e përgjithshme në fushën e financës dhe kontabilitetit për tu pasuar në vitet e tjera me lende kryesive profesionale në fushën e programit. PS kombinon si trajtimin teorik ashtu edhe atë aplikativ sidomos në lëndet e menaxhimit. (Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr. 14 ;nr.14.1 ; nr.14.2 dhe nr.19)</p>			
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmërinë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit është mbështetur në eksperiencën e programeve të tilla kombëtare, por para se gjithash ato ndërkombëtare. Gjithashtu, ky program u mundëson hyrjen në tregun e punës të studentëve në segmentin e sektorit financiar e bankar. (Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr. 14 ;nr.14.1 ; nr.14.2 dhe nr.19)</p>			
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Në shumicën e programeve të lendeve të shqyrtuara në evidentuam element praktik të tij në formën e diskutimeve të rasteve studimore. Nga ana tjetër, referuar dokumentit të Bordit të Tregut të Punës (përfshin 15 përfaqësues nga ndërmarje dhe institucione) në evidentuam takime të këtij bordi dhe diskutim të problematikes me stafin e DEF-se . (Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr. 12 dhe 12.1)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>0 Përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht X</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

<p>Standardi II.5 Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në realizimin e këtij program që kryesisht është PAE (98% ose nga 39 anëtarët të stafit që mbulon këtë program vetëm 1 është PAK) plotëson kërkesat e legjisllacionit në fuqi dhe akteve nënligjore. (Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr. 23; 24 dhe nr 25)</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për</p>	<p>Mbështetur në CV e stafit akademik që mbulon këtë program si dhe në informacionin tabelor që ofron institucione evidentojmë se ai plotëson kriteret akademike dhe kualifikuese të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kështu duke analizuar të dhenat tabelore lidhur me stafin akademik të programit në vitin aktual të studimit 2021-2022 nga 39 anëtarë stafi gjithsej 6 anëtarë janë me titullin akademik Profesor, 12</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al





<p>drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>janë me gradën shkencore Doktor dhe 21 janë asistent lektor me kualifikimin MsC. Ne kete vit aktual akademik pothuajse gjithë PS zhvillohet nga PAE (38 antare) dhe vetem 1 antar stafi është PAK. Nga analiza e angazhimit të stafit në dy vitet e mëparshme shohim që në stafit akademik si PAK ka ardhur në ulje nga 10 antare të angazhuar në vitin akademik 2019-2020 në 4 antare të angazhuar në vitin akademik 2020-2021. Edhe në aspektin cilësor kemi rritje të angazimit në këtë program nga viti në vit të stafit PAE me tituj akademik. (Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr. 23; 24 dhe nr 25)</p>			
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është i kualifikuar në përputhje me objektin apo fokusin e modulit/lëndës që zhvillon në program. Kualifikimet e stafit dhe eksperiencia e tyre përputhen me profilin e programit. (Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr. 23; 24 dhe nr 25)</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik që mbulon këtë program është angazhuar në ndjekjen e procesit të praktikës profesionale të studentëve pranë këtyre institucioneve. Nga vizita në institucion, në takimin me stafin që mbulon këtë program, GVJ evidentoi që anëtarë të stafit janë caktuar për të ndjekur si praktikën e studentëve të këtij viti akademik që tashmë e kishin përfunduar, ashtu edhe si drejtues për punimin e diplomës. (Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr. 20 ; 23; 24 dhe nr 25)</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>UET dhe njësi kryesore, FEBZH, ofron personel ndihmës mësimor shkencor për realizimin e orëve praktike apo shërbime të tjera në funksion të procesit mësimor. Për këtë pedagogu përkatës, e zhvillon mësimin praktik pranë laboratorit në të cilin është edhe prezenca dhe ndihma e personit ndihmës përgjegjës lidhur me anën teknike të përdorimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X


III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	Përmirësimi të procesit të mësimdhënies në UET i shërbejnë edhe aktet rregullative të miratuara siç është rregullorja përkatëse apo dokumenti i parimeve të ndërtimit të programit të lendes apo ai i trajnimeve profesionale të stafit dhe studenteve. në këtë të fundit evidentohen trajnimet në kuadër të projekteve të ndryshme që institucioni ka me partnere vendas dhe të huaj. (sidomos training mobilities in ERASMUS project) <i>(Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.33; dhe nr 39)</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Bazuar në organigramën e Institucionit si dhe në takimet e realizuara në Institucion, monitorimi dhe vlerësimi periodik i aftësisë mësimdhënëse të stafit akademik dhe ndihmës të programit realizohet në nivel institucional nga Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC), ndërsa në nivel të njësisë kryesore nga FEBZH. Këto dy struktura përgjegjëse monitorojnë dhe vlerësojnë periodikisht mësimdhënien nëpërmjet performancës akademike që kryen Departamenti si dhe anketimeve me studentët e programit në fund të çdo semestri. Ky vlerësim paraqitet në formën e një raporti të veçantë dhe u paraqitet instancave përkatëse për analizë të mëtejshme dhe miratim. Vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies e prezanton nëpërmjet raporteve periodike pranë instancave vendimmarrëse përkatëse më të larta si dhe pranë DEF. Një mënyrë tjetër vlerësimi është edhe hartimi në fillim të vitit akademik i planit të punës për secilin pedagog, i cili monitorohet për zbatim nga drejtuesi i FEBZH dhe DEF. Përmbushja e këtij plani pune është një nga vlerësimet e performancës së pedagogut <i>(Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr. 40 dhe nr 60)</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	UET, nëpërmjet strukturave përkatëse, kryen periodikisht vlerësimin e veprimtarisë akademike dhe administrative nga ana e studentëve përmes metodave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta. <ul style="list-style-type: none"><i>Metoda të tërthorta:</i> kryesisht në formën e anketimeve me studentët, për të gjitha lëndët dhe të gjithë pedagogët. Ky anketim zhvillohet dy herë në vit në fund të çdo semestri. Përpara se të zhvillohet provimi. Rezultatet e anketimit bëhen të ditura stafit nëpërmjet raportit të dalë për këtë qëllim, i cili

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al






	<p>analizohet në mbledhjen e Departamentit dhe që shërben për të përmirësuar punën në të ardhmen. Rezultatet e tyre i vë në dispozicion të drejtuesve të Institucionit, atyre të Fakulteteve dhe Departamenteve ku edhe analizohen si dhe reflektohen në vlerësimin e performancën së çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik. Nga takimi me stafin e departamentit u evidentua rast të marrjes së masave ndaj pedagogut.</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Metoda të drejtpërdrejta:</i> përfshijnë vlerësimin me pikë për stafin në bazë të formularit të caktuar. Në skedën përkatëse të vlerësimit të pedagogut u evidentua një praktikë vlerësimi e materializuar në skedën përkatëse të vlerësimit të pedagogut. <p>(<i>Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.5; 40 dhe nr 60 si dhe dokumenti shtese i kërkuar nga GVJ për evidentimin e një rasti të problematikes së dale nga anketimi.)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse për monitorimin e mësimdhënies, KSBC nëpërmjet Komisionit të Vlerësimit të Performancës dhe DEF-përgatitin dhe shpërndajnë në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi cilësinë e mësimdhënies, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese në nivel Fakulteti dhe Departamenti por edhe pedagogëve, sikurse dhe aktorëve të tjerë të interesuar.</p> <p>Këto raporte janë pjesë e diskutimit/prezantimit në nivel departamenti, dekanati dhe rektorati bazuar në evidencën nr.11 e cila plotësohet nga studenti si vlerësim për pedagogun.</p> <p>(<i>Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.5; 40 dhe nr 60)</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>KSBC bazuar në rezultatet e anketimit dhe vlerësimin me pikë të procesit të mësimdhënies për çdo personel akademik mësimdhënës, harton një raport periodik vjetor të ecurisë së programeve të studimit mbi problematikën e dalë.</p> <p>Në funksion të kësaj problematike instancat drejtuese në qendër dhe ajo e njësisë bazë mësimore shkencore, parashtrojnë masat që duhen ndërmarrë për përmirësimin e procesit dhe rritjen e cilësisë.</p> <p>Institucioni analizon mbi bazë Fakulteti dhe Departamenti ecurinë e programeve të studimeve, duke përfshirë edhe opinionin e studentëve.</p> <p>(<i>Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.5; 40 dhe nr 60)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Standardi III.2 Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet,</p>	<p>Mësimdhënia në programin Bachelor në "Finance" bazohet në rregulloren mësimore në nivel institucional dhe rregulloren e FEBZH të cilat përcakton format e mësimdhënies dhe vlerësimin e dijeve të studentëve. Procesi mësimor zhvillohet nëpërmjet formave të mirënjohura: leksione,</p>



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>seminaret, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>seminare, detyra kursi, ushtrime, etj, të organizuara në 32 lëndë, ku janë parashikuar provime me shkrim, praktika dhe tema e diplomës. Lëndët klasifikohen vetëm si lëndë të detyruara.</p> <p>Në këtë program lëndët zhvillohen sipas syllabusit përkatës dhe në liri të plotë të personelit akademik. Për të ruajtur objektivitetin e vlerësimit forma e kontrollit në program është me shkrim dhe e sekretuar. Në politikën e Institucionit është praktikë që nota e studentit të jetë e “ndërtuar”, që do të thotë që studenti testohet gjatë semestrit në secilën lëndë përveç provimit përfundimtar në sezon. Shumatorja e pikëve të mbledhura përbën vlerësimin e tij përfundimtar. Forma e vlerësimit referuar ECTS përcaktohen me notë (1 deri 10) dhe ekuivalentin e notave nga F në A. Ky sistem vlerësimi përfshin 100 pikë, të cilat përgjithësisht janë të ndara në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 10 % frekuentimi dhe vlerësimi gjatë semestrit; • 30 % provim i ndërmjetëm apo detyra e kursit që zhvillohet në mes të semestrit; • 60% provimi përfundimtar që zhvillohet në fund të semestrit. <p>Mënyra e vlerësimit të studentëve është e prezantuar në syllabusin e çdo lënde.</p> <p><i>(Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.19 dhe nr 39)</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Personeli akademik që mbulon këtë program ka aftësitë pedagogjike bashkëkohore në mësimdhënie rrjedhojë kjo edhe e eksperiencës relativisht të gjatë në procesin e mësimdhënies. Nga ana tjetër, nga takimi me studentët e këtij programi, GVJ evidentoi faktin e marrjes parasysh në dy raste të kërkesave të studentëve lidhur me përmirësimin e procesit të mësimdhënies për të kryer më shumë seanca seminare praktike në laborator duke rritur nivelin praktik të mësimnxënies nga studentët.</p> <p><i>(Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.20 dhe takimi me stafin akademik dhe studentët e programit)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të nxënies, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Bazuar në takimin me stafin e DEF rezultojnë se UET mbështet stafin akademik në përmirësimin e metodës pedagogjike kryesisht nëpërmjet vizitave pranë universiteteve homologe të huaja, si dhe mobiliteteve në kuadër të projektit ERASMUS +.</p> <p>Bazuar në RVB, Institucioni ka organizuar trajnime të strukturuar në nivel universiteti dhe Fakulteti (Ditën e Zhvillimit të Stafit) me ekspertë të fushës së pedagogjisë.</p> <p><i>(Shqyrtimi i dokumentave bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.57)</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i</p>	<p>Personeli akademik që mbulon këtë program ka ekspertizën duhur për një</p>

angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	proces mësimdhënie të suksesshëm. Bazuar në CV-të e stafit akademik, vëmë re që pothuajse të gjithë kanë një formim akademik dhe profesional në fushën e Financës dhe lendeve që karakterizojnë profilet. Kjo është arsyeja se një pjesë e stafit të këtij programi janë nga departamente të tjera të fushës informatikës matematikës etj. (Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.20 dhe takimi me stafin akademik			
Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Vlerësimi i formave të mësimdhënies përfshihet si pjesë e raportit të përgatitur në nivel Departamenti lidhur me problematikën e dalë nga anketimi me studentët e cila analizohet në njësinë bazë. Problematikat e dala nga anketimi i studentëve diskutohen në këtë njësi me synim rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Në takimin me studentët e programit ata prezantuan edhe sugjerimin që kishin bërë në Departament për disa lëndë që kishin një nivel të lartë teorik shkencor për tu trajtuar në një nivel me aplikativ të cilat ishin marrë në konsideratë nga pedagogët përkatës të lëndëve. Ky sugjerim theksonte përdorimin më të madh të rasteve studimore. (Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.20 dhe takimi me stafin akademik			
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	Eksperiencia në mësimdhënie e stafit të programit bën që të përdoren format interaktive duke ndërthurur trajtimin teorik me atë aplikativ. Një zhvillim të mëtejshëm të këtyre metodave e përben dhe realizimi i mësimit online gjatë situatës pandemike			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Nga takimi me studentët e programit u evidentua një bashkëpunim reciprok i frytshëm mes tyre dhe personelit akademik. Nga ana tjetër për tema me praktike janë ftuar të zhvillojnë ato edhe eksperte të fushës përkatëse. (Takimi me stafin gjate vizitës ne institucion)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Pa përmbushur	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi III.3	
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Mbeshtetur në dokumentacionin e paraqitur për palikim nga institucioni si dhe nga vizita e GVJ në ambientet e UET evidentojmë realizimin e këtij program studimi në ambiente të përshtatshme që janë në dy godinat e institucionit. Sallat e leksionit dhe laboratorët përkatës kane gjithë infrastrukturën e nevojshme për realizimin normal të procesit mësimor e shkencor. (Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.42 dhe

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<i>nr.42.1)</i>
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Ambientet ku zhvillon mësimin ky program studimi janë funksionale dhe ofrojnë logjistikën e nevojshme në shërbim të procesit mësimor. Laboratori i informatikës ofron kapacitetin e nevojshëm për të realizuar nevojat e programit në shfrytëzimin e kësaj teknologjie. Për zhvillimin e mësimi pedagogët përdorin video projektorët të cilët së bashku me kompjuterin janë të instaluar në sallën e leksionit. (<i>Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.42 dhe 42.1 dhe vizita verifikimi në institucion</i>)
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	UET përdor sistemin e menaxhimit të të dhënave të studentëve me platformën përkatëse (sistemi MOODLE UET LMS) ku mundësohet informimi i integruar i informacionit student-pedagog, ku studentet marrin materialet mësimore të pedagogëve përkatës. Nga takimi me studentët u evidentua përdorimi i kësaj platforme si dhe shfrytëzimi i rrjetit IT në ambientet e institucionit. Në këtë sistem studenti mund të regjistrohet në kursin përkatës, të marrë orarin mësimor, të kontrollojë vlerësimin, etj. (<i>Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.46 dhe 46.1</i>)
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	GVJ bazuar në programin e studimit Bachelor në Finance, silabuset e hartuara për çdo lende të këtij program evidentoi se përgjithësisht studenteve u vihet në dispozicion që në fillim të semestrit literature baze që është kryesisht e përfaqësuar nga një tekst i botuar/ribotuar gjate viteve të fundit ose leksione të parashikuara nga titullari si dhe kane akses në literature ndihmëse nëpërmjet botimeve të ndryshme. UET vazhdon të aplikojë edhe përdorimin e teksteve të përkthyer të autoreve të njohur në fushën e financës. (<i>Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.45 dhe 45.2</i>)
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Institucioni ka tashme një bibliotekë tashme të konsoliduar me një fond të madh librash. Një pjese e këtij fondi plotëson kërkesat e programit Bachelor në Finance me tituj tekstesh në shqip me autore akademik vendas dhe në gjuhë të huaj me autore të teksteve ndërkombëtarë universitar (dokumenti i inventarit të teksteve për këtë program). Gjithashtu në evidentuam edhe të printuara leksione të parashikuara të lendeve nga titullarët përkatës. Katalogu me libra elektronik në gjuhë të huaj plotëson me mire këtë nevojë të studenteve. Biblioteka ka hapësirën e nevojshme të leximit si dhe kompjuterët në dispozicion të studenteve për të marrë informacionin e duhur. (<i>Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.45 dhe 45.2 dhe 45.3</i>)
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Personeli akademik dhe studentet kane në përdorim edhe sistemin online të botimeve të kërkuar ofruar në ambientet e saj. në të jepet mundësi që nëpërmjet burimeve elektronike të aksesosh edhe artikuj apo libra shkencor duke qene kështu pjese e sistemit COBISS. (<i>Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.45 dhe 45.2</i>)



<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Institucioni ofron infrastrukturën e nevojshme informatike në funksion jo vetëm të realizimit të mësimit por edhe të plotësimit të kërkesave të studenteve për të përdorur këtë sistem pranë kompjuterëve në bibliotekë, laboratorët që disponohen apo edhe në kompjuterët e vendosura në auditorë. (Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.45 dhe 45.2)</p>			
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Në funksion të procesit mësimor personeli akademik dhe studentët përdorin platformën online në hedhjen e materialeve mësimore dhe informimin e studentëve mbi procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Pedagogë të caktuar përdorin platformat elektronike të komunikimit on-line në raste të caktuara për komunikim me studentët, siç janë: google classroom, zoom, etj. (Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.46 dhe 46.2)</p>			
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Evidentohet përdorimi i platformës “UET LMS” krahas asaj të zakonshme “google classroom” në procesin e mësimdhënies gjatë situatës pandemike, që përkoi me semestrin e dytë. Nëpërmjet këtij sistemi merret, dërgohet dhe koordinohet informacioni pedagog student. (Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.46; 46.2 dhe 46.3)</p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Nga takimi me stafin e departamentit dhe me grupin e studenteve të programit evidentuam realizimin e procesit të diplomimit të studenteve që përfshin përcaktimin, monitorimin, ndjekjen dhe mbrojtjen e diplomës si një proces koordinimi të stafit me studentet. në njësinë baze DEF miratohen mentorët e diplomave , përcaktoheshin tezat e mbrojtjes dhe ndiqej ky proces deri në finalizim. (Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.6,7 dhe nr 10)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të</p>	<p>Në kuadër të plotësimit të kërkesave ligjore dhe nënligjore UET ka ngritur Komisionin e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë (KBSC) që është një strukturë në nivel institucional. Kjo strukturë ndjek dhe vlerëson cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies të programeve të studimit. KBSC koordinon punën me njësinë bazë që është DEF që mbulon këtë program. DEF ka të caktuar një koordinator/ mbikëqyrës të programit që mban kontakte të vazhdueshme me KBSC-në</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

cilësisë së mësimdhënies.	
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	FEBZH si njësia kryesore dhe DEF si njësia bazë ndjekin në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshme nivelin e cilësisë së mësimdhënies në këtë program studimi. Përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të mbarëvajtjes së programit dhe cilësisë së tij e ka DEF i cili bën analiza periodike dhe raporton tek Dekanati i Fakultetit dhe pranë KBSC-së, e përcaktuar kjo edhe në planin e punës që hartojnë njësitë përkatëse për vitin akademik. (<i>Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.6 dhe 7</i>)
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	DEF si njësi bazë dhe monitoruese e programit, nxit zhvillimin e metodave të reja mësimdhënëse nëpërmjet organizimit të leksioneve të hapura me personalitete të njohura të fushës së financës apo zhvillimin e lëndëve apo pjesë të saj nga profesorë të ftuar. Bazuar në dokumentacionin shtesë që institiuioni ka sjellë (pas shqyrtimit të draft raportit të GVJ nga institucioni se bashku me komentet) evidentohet se janë zhvilluar leksione të hapura nga personalitete apo profesionistë të mirenjohur me studentët e këtij programi. (<i>Referenca nr.4-11, shtese derguar me komentet nga institucioni</i>)
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion GVJ evidentoi përpjekje të stafit të programit për të rritur kualifikimin e tyre dhe marrë eksperiencën të reja në procesin mësimor e shkencor. Kjo është arritur nëpërmjet vizitave që anëtarë të stafit kanë realizuar në kuadër të projekteve të shkëmbimit ERASMUS, pjesëmarrje të stafit në disa projekte kërkimore shkencore si dhe në prezantime të punimeve të tyre në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. (<i>Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.57</i>)
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Krahas shkëmbimeve të stafit nëpërmjet projekteve të bashkëpunimit me institucione homologe një mënyrë tjetër e rritjes së kualifikimit veçanërisht të stafit që zotëron MSc është edhe realizimi i leksioneve të hapura me specialist apo personalitete të njohura të fushës. (<i>Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.57</i>)
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Nga takimi me stafin që mbulon këtë program u evidentua angazhim serioz i tij në zbatimin me përgjegjshmëri të realizimit të programit mësimor, duke i dhënë rendësi procesit të mësimdhënies nëpërmjet përdorimit të metodave aplikative sidomos në lëndët karakterizuese. Këtu ritheksojmë përdorimin e metodave aplikative të prezantuara nga specialiste të mirënjohur të fushës. (<i>Informacion i marre nga takimi me stafin</i>)
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e	Eksperiencën në mësimdhënie e numrit me të madh të personelit akademik që mbulon këtë program është një faktor i rëndësishëm për realizimin e procesit të mësimdhënies sa me bashkëkohor dhe të përmirësuar me arritjet në këtë drejtim. Marrja e eksperiencave nga stafi të metodave bashkëkohore të kolegeve të tyre pranë universiteteve të huaja është

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



pritsmërinë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	realizuar nëpërmjet mobiliteteve në kuadër të projekteve ERASMUS ku institucioni është parter.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.5			
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.			
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyra e testimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë në rregulloret e posaçme, të cilat janë pjesë zbatuese si në nivelin institucional (Rregullore e UET), njësisë kryesore dhe rregulloren e këtij programi. Këto dokument janë të publikuara dhe studentët kanë akses në to. Më të specifikuarat mënyrat e testimit jepen në syllabuset e lëndëve përkatëse. (<i>Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.5; 7 dhe nr.19</i>)		
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Bazuar në dokumentacionin e ofruar dhe vizitën në institucion, GVJ evidenton se studentët e programit informohen mbi mënyrën e vlerësimit të njohurive nëpërmjet: <ul style="list-style-type: none"> • Informacionit të marrë në ëbin e institucionit pasi rregulloret në këtë drejtim janë të përfshira në te. • Informacionit që marrin që në fillim të semestrit përkatës nëpërmjet syllabuseve të lëndëve përkatëse të pedagogëve përgjegjës për zhvillimin e tyre. (<i>Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.5; 7 dhe nr.19</i>)		
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Vlerësimi i njohurive të studentëve realizohet në format tashmë të konsoliduar dhe përfshijnë elementë të vlerësimit të vazhdueshëm në seminar, testimin e ndërmjetëm, detyrat e kursit, provimin përfundimtar etj, elementë këto që u evidentuan të përcaktuara në syllabuse. (<i>Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.5; 7 dhe nr.19</i>)		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive të studentëve bazohet në praktikat më të mira të përdorura në IAL. GVJ, gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, evidentoi praktika të këtij programi, në disa nga lëndët për të cilat ishte përmbyllur vlerësimi. Njohuritë e marra gjatë zhvillimit të këtyre lëndëve vlerësohen me 40% të notës përfundimtare (angazhim në seminar dhe detyra e kursit), ndërsa provimi përfundimtar zë 60 % të vlerësimit, duke reflektuar kështu edhe përcaktimin e këtij vlerësimi sipas syllabusit. Mendojmë se kjo metodë vlerësimi i jep mundësi studentit të angazhohet gjatë gjithë semestrit dhe siguron një vlerësim më objektiv të angazhimit të tij në auditor dhe jashtë tij.</p> <p>(Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr..19 dhe evidentimi i dokumentacionit gjate vizitës në institucion)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive të studentëve përcaktohen në rregulloret përkatëse në nivel institucioni, njësie kryesore dhe njësie bazë. Për të gjitha lëndët e programit realizohet testimi dhe vlerësimi me shkrim. GVJ evidentoi një praktikë të tillë ku u pa që ruhej sekreti dhe konfidencialiteti i testit si dhe bëhej sekretimi përkatës i tezës dhe zgjidhjes së studentit. Vitet e fundit UET ka ndërruar iniciativë duke promovuar sistemin e ri të vlerësimit elektronik “clean scoring”. Ky sistem është aplikuar në një numër të kufizuar lëndesh dhe institucioni synon ta shtrijë gjerësisht në të ardhmen..</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Për realizimin e testeve dhe vlerësimin e dijeve të studentëve DEF, bazuar në rregulloret përkatëse, në bashkëpunim me sekretarinë mësimore, miratojnë komisionet e provimit me një numër anëtarësh stafi jo më pak se 2, ku njëri është titullari i lëndës dhe tjetri është asistenti apo pedagog i fushës përkatëse. GVJ evidentoi nënshkrimin e anëtarëve të komisionit në procesverbalet e provimeve të lëndëve, si dhe praktikave profesionale të firmosura nga 2 anëtarët e komisionit të provimit dhe Përgjegjësi i DEF.</p> <p>(Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr. 7 dhe evidentim gjate vizitës në institucion)</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Zhvillimi i testimit të vlerësimit bazohet në anonimitetin dhe monitorim nga DEF. Kushtet e zhvillimit të provimit janë optimale dhe hapësirat ndërmjet studentëve në këtë proces janë të përshtatshme.</p> <p>(Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr; 7 dhe nr.9)</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi me 40% dhe në disa lende deri 50-60 % të pikëve të dijeve gjatë vitit jo vetëm i “mban të angazhuar” vazhdimisht studentët, por u mundëson të diskutojnë dhe të këshillohen me pedagogët përkatës për të përmirësuar mësimnxënien e tyre sidomos kjo për detyrat e kursit të cilat në shumicën e lëndëve karakterizuese janë edhe aplikative. GVJ evidentoi formatin e disa testeve dhe konstatoi që format e pyetjeve dhe ushtrimeve praktike përmbajnë elementë standard të vlerësimit: pyetje me alternativa, pyetje me koment, ushtrime etj.</p> <p>(Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.5; 7</p>



	<i>dhe nr.19)</i>			
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	Bazuar në kuadrin rregullator në nivel institucional dhe të njësisë bazë, DEF monitoron zhvillimin normal të testimit duke u përpjekur që ai të jetë realist dhe vlerësimi të jetë meritë e angazhimit të studentëve me njohuritë e kërkuara duke eliminuar sa më shumë format e kopjimit apo të abuzimit në këtë drejtim. në rregulloren përkatëse evidentohen edhe mjaft detaje në funksion të realizimit të provimit sa me serioz.. (<i>Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.5; 7</i>			
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Realizimi me korrektësi i testimeve gjatë vitit akademik dhe në fund të tij është një garanci për vlerësimin e saktë të studentëve. Përgjigjet e testimit merren nga studentët brenda 7 ditëve nga zhvillimi i tij dhe ata kanë të drejtën e reklamimit të tij, siç edhe është parashikuar në rregulloren përkatëse. (<i>Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.5; dhe nr.7</i>			
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Nga takimi me studentët, GVJ evidentoi faktin se përpara se pedagogu të dërgojë procesverbalin në sekretarinë mësimore lihet një ditë reklamimi për ta nëse ndonjë ka paqartësi apo pretendime mbi vlerësimin. (<i>Evidentim nga vizita në institucion</i>)			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimit, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Praktikat e ankimit të studentëve lidhur me vlerësimin kanë qenë të pakta në numër të evidentuara nga takimi me grupin e studenteve.. Por, në rastet e evidentuara, Departamenti ngre komision vlerësimi të posaçëm dhe procesi dokumentohet deri në fund. Koordinimi me pedagogut dhe studenteve arrihet nëpërmjet sistemit LMS.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi arrin të pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme në fushën e financës. Programi synon që të rrisë edhe kompetencat profesionale të studentëve me fokus rritjen e aftësive praktike në financiare me 4 profilet përkatëse. Mbështetur në 32 lëndët që ofron programi, por edhe në praktikën profesionale të përfshirë në të, ai arrin të ketë objektiv formimin teorik dhe relativisht edhe atë profesional të studentëve. Në këtë kuadër praktika profesionale dhe përgatitja e diplomës që synohet të jetë aplikative, i shërbejnë këtij objektiv dhe rrisin më shumë përgatitjen profesionale të studentëve. (<i>Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.14;</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


	14.1 dhe nr.14.2)
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Bazuar në programin mësimor, ky program studimi garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e financës me 4 profile. Njëkohësisht gjejnë relativisht trajtime në zhvillimin e aftësive në fushën e informacionit në trajtimin e rasteve studimore në lëndët e analizës dhe menaxhimit të aplikuara në këtë fushë. (<i>Shqyrtimi i dokumenteve bashkangjitur në aplikim; Evidenca nr.14; 14.1 dhe nr.14.2</i>)
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Nga takimi me stafin e programit dhe studentët, GVJ evidentoi që në orën e fundit të leksionit bashkëbisedojë mes pedagogut dhe studentit realizimi i programit të lëndës (<i>bazuar në syllabusin e paraqitur që në fillim të semestrit</i>). (<i>Evidentim nga vizita në institucion</i>)
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	Pedagogu i lëndës përkatëse, në fund të zhvillimit të mësimin, bën një përmbledhje të temave të trajtuara dhe orienton studentët lidhur me testin përfundimtar që do zhvillohet në sezonin e provimeve. (<i>Evidentim nga vizita në institucion</i>)
Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Anëtarë të stafit kanë marrë eksperiencë dhe njohuri bashkëkohore mbi zhvillimet e reja të shkencës dhe teknologjisë, kryesisht nëpërmjet angazhimit individual, vizitave në institucione universitare të huaja në kuadër të projekteve, apo gjatë angazhimit në projekte.
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Bazuar në dokumentacionin dhe takimin e zhvilluar me stafin e programit, konstatohet që anëtarë të tij realizonin zhvillimin e programit në tema të caktuara nëpërmjet në laboratorët përkatës. në me të shumtën e rasteve përgatitja e Detyrës se kursit behet laboratorin e informatikës.
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Stafi i programit diskuton gjatë zhvillimit të programit por sidomos në fund të tij çështje specifike që kryesisht kanë të bëjnë me aplikimin e njohurive të marra kryesisht në lëndët karakterizuese që lidhen me financën dhe profilet përkatëse. Kjo u evidentua në takimin me stafin që mbulon këtë program. (<i>Evidentim nga vizita në institucion</i>)
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Stafi i programit realizon një bashkëbisedim dhe komunikim të frytshëm me studentët për të marrë nga ata sugjerimet me qëllim rritjen e cilësisë mësimdhënëse. Një element i rëndësishëm në funksion të këtij qëllimi është edhe pyetësori që realizohet nga studentët në fund të semestrit ku në të ka rubrikë për këtë qëllim. (<i>Evidentim nga vizita në institucion</i>)

Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	Nga takimi me studentët e programit GVJ evidentoi që mbështetja e studentëve konsiston në krijimin e klimës favorizuese dhe të përshtatshme për të realizuar detyrat e kursit. Kjo arrihet nëpërmjet kontakteve apo njohjeve që pedagogu i lëndës ka me drejtues institucionesh duke mundësuar angazhimin e tyre me studentët. <i>Nga ana tjetër GVJ nuk evidentoi që studentë të këtij programi të kishin marrë mbështetje financiare në këtë drejtim.</i>			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Në rang institucioni GVJ evidenton forma bashkëpunimi mësimdhënieje me institucione homologe vendase por edhe ndërkombëtare. UET ka mobilitete shkëmbimi me universitete të huaja. Mobilitetet e realizuara përfshijnë kryesisht shkëmbimet mes stafeve si dhe mobilitete studentësh që kanë studiuar për një periudhë afatshkurtër në universitetet e huaja partnere. <i>Nga studentët e këtij programi në evidentuam realizimin të tre mobiliteteve të tillë, ndërsa janë realizuar një numër i konsiderueshëm mobilitetesh nga studentë të programeve të tjera.</i> (Evidentim nga vizita ne institucion)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Studentët e këtij programi, pas përmbylljes së gjithë detyrimeve dhe mbrojtjes së praktikës, kanë të drejtën e mbrojtjes së diplomës përmes një punimi (ku kriter është nota mesatare) ose nëpërmjet dhënies se provimit të formimit si provim i përgjithshëm. Procedura e mbrojtjes përfundimtare, diplomimit, është e përcaktuar në rregulloren e Institucionit dhe dokumentin “Mbi punimin e diplomës) dhe rregulloren e programit. Ky proces zbatohet nga DEF. Këtu jepen detaje lidhur me strukturën e punimit të diplomës, listën e pedagogëve udhëheqës, listën e sugjeruar të temave të mundshme orientuese etj. Disa nga studentet që në takuam gjate vizitës në institucion ishin të kursit të III-te dhe vazhdonin përgatitjes përfundimtare të punimit apo përgatitjes për provimin përfundimtar.. (Evidentim nga vizita në institucion si dhe aneksi nr.5 dhe nr 7)
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	DEF, si njësi bazë e programit, së bashku me strukturat ndihmëse, informojnë, ndjekin dhe monitorojnë procesin e mbrojtjes së diplomës me punimin e diplomës. Pas marrjes së informacionit studentët plotësojnë formularin e aplikimit ku përcaktojnë fushën e studimit, strukturën paraprake të tij dhe propozimin për udhëheqësin e punimit. Në DEF përcaktohen udhëheqësit për çdo student, të cilët kanë përgjegjësi për mbarëvajtjen e këtij procesi, cilësinë dhe përfundimin në afat. Ky proces u evidentua edhe gjatë vizitës në institucion. (Evidentim nga vizita në institucion)
Kriteri 3. Komisioni i	Lidhur me diplomimin e studentëve, me propozim të përgjegjës të DEF



<p>posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>dhe miratimit nga Dekani, ngrihet Komisioni i Provimit të Formimit i cili në vlerësimin e punimit të diplomës bazohet në katër kriteret kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ecurinë dhe nivelin e vlerësimit të marrë në mësimet gjatë vitit akademik; • Vlerat teorike shkencore dhe profesionale të punimit; • Vlerësimin që jep pedagogu udhëheqës i punimit të studentit në formularin përkatës; • Nivelin e prezantimit të punimit nga studenti. <p>GVJ konstatoi se kjo praktikë rezulton e plotësuar nga evidentimi me studentë të programeve të tjera që kanë përfunduar programin, pasi studentët e këtij programi ende nuk e kanë përmbyllur programin. (<i>Evidentim nga vizita në institucion</i>)</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>Në funksion të fushës së punimit të propozuar nga studenti, DEF miraton listën e pedagogëve udhëheqës për temat e studentëve. Udhëheqësit e punimeve të diplomës gjatë periudhës së përgatitjes së tij nga studenti mbajnë komunikim të vazhdueshëm duke i orientuar përgjatë kësaj kohe. Roli udhëheqës i pedagogut është këshillues dhe orientues lidhur me përmbushjen e objektivave të qëllimit të punimit, shfrytëzimin e literaturës bashkëkohore nga studenti dhe përfshirja e analizës teorike praktike në punim. (<i>Evidentim nga vizita në institucion</i>)</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Gjatë përpunimit të të dhënave të punimit studentët kanë të gjitha mundësitë teknike dhe asistencën e nevojshme për të realizuar këtë fazë të rëndësishme të punimit në laboratorët që ofron institucioni, bibliotekën dhe çdo infrastrukturë të dobishme për ta. (<i>Evidentim nga vizita në institucion</i>)</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Nga takimi me studentët e Kursit të II-të të këtij programi, u evidentua bashkëpunimi deri në këtë fazë afër përmbylljes të realizimit të punimit të diplomës me udhëheqësin e punimit. Kjo manifestohet në ndjekjen sistematike dhe këshillat e vazhdueshme për studentët, duke filluar që nga faza e konceptimit. Rol të rëndësishëm ai ka në asistencën që jep sidomos me metodologjinë e punimit që është kyçi i një punimi të suksesshëm dhe sidomos në aspektin e aplikimit të të dhënave të siguruar. Në rastin e punimeve të diplomës për studentët e këtij programi synohet që ai në strukturë trajtimi aplikativ të zërë një peshë të konsiderueshme. (<i>Evidentim nga vizita në institucion</i>)</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Komisioni i Provimit të Formimit bazuar në katër kriteret e përmendura më lart, bën vlerësimin e punimit të diplomës me notë përfundimtare. (<i>Evidentim evidenca nr. 7.2 dhe nga vizita në institucion</i>)</p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për</p>	<p>Në përfundim të studimeve studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e saj të miratuar nga MASR. Diplomës i bashkëngjitet edhe lista e notave. GVJ verifikoi praktikën përkatëse lidhur me diplomimin e studentëve që i përket vitit akademik 2020-2021, që është përmbyllur.</p>



arsimin.									
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Pas përfundimit të studimeve studentit pajiset me kopjen e plotë zyrtare të programit të studimit, diplomën dhe suplementin e saj. Gjate vizites ne sekretarine mesimore ne verifikuam keto dokumente te cilat jane te njejta me modelet perkatese te aplikimit te institucionit dhe qe permabanit te gjithë elementet e nevojshem te vleresimit te tij. Institucioni kishte ne dispozicion te studenteve dhe dosjen perkatese te syllabusve te zhvilluar ne program e cila u vihej ne dispozicion studenteve ne rast se do kerkohej prej tyre. <i>(Evidenca nr.15 si dhe verifikimin ne institucion)</i>								
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Nga vizita në institucion rezulton se procesi i ruajtjes së gjithë dokumentacionit bazohet në kërkesat ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi. Gjithashtu të dhënat e tij ruhen edhe në sistemin informativ të institucionit.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si	Të dhënat e personelit akademik mblidhen, ruhen dhe përditësohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore. Kjo Zyrë është pjesë e strukturës administrative të UET, pjesë e Njësisë së Standardeve dhe Cilësisë (Evidenca 5, Rregullore e UET, Kreu II, Neni 6, pika 6.1, nënpika 2c.) Zyra e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për të mblledhur dokumentacionin dhe për të ndjekur procedurat sipas ligjit dhe rregulloreve të brendshme të institucionit në lidhje me rekrutimin e stafit të ri akademik. E njëjta Zyrë është përgjegjëse për të përditësuar dokumentacionin e stafit ekzistues akademik dhe për të ndjekur procedurat ligjore në lidhje me marrëdhënien kontraktuale të tyre me institucionin <i>GVJ kontrollon në mënyrë rastësore dosje të personelit akademik dhe</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.	<i>ndihmës akademik dhe vërejtje mungesë dokumentacioni tek dosja e pedagogut me kohë të pjesshme (K. H. i mungonte lista e notave). [Evidenca 5, Rregullore e UET, Kreu II, Neni 6, pika 6.1, nënpika 2c; Evidenca 11, Dokumenti G. Rregullore për Burimet Njerëzore]</i>		
Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	Institucioni ka procedura për rekrutimin e personelit akademik të cilat janë të reflektuara në Dokumentin G. Rregullore për Burimet Njerëzore, pika GI Politikat dhe Procedurat e rekrutimit të personelit akademik dhe sipas ligjit nr.80/2015, neni 64 dhe të cilat ndiqen në mënyrë rigoroze nga Zyra e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Departamentin e Ekonomiksit dhe Financës. [Evidenca 11, Dokumenti G. Rregullore për Burimet Njerëzore, pika GI]		
Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	Institucioni i përshkruan në mënyrë të detajuar kriteret për rekrutimin e personelit akademik të cilat janë të reflektuara në Dokumentin G. Rregullore për Burimet Njerëzore, pika GI2, GI3 dhe të cilat bëhen publike gjatë thirrjeve të hapura për rekrutim (Dokumenti 11.1 Shembull thirrje për staf akademik). Publikimi i tyre bëhet nëpërmjet faqes së internetit të universitetit dhe rrjeteve sociale. [Evidenca 11, Dokumenti G. Rregullore për Burimet Njerëzore, pika GI2 dhe GI3, dhe Evidenca 11.1. Shembull thirrje për staf akademik]		
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Institucioni vlerëson kandidaturat e stafit akademik bazuar në Rregulloren për Burimet Njerëzore pikat GI8, GI9 në bazë të kërkesave të paravendosura dhe të thirrjes së publikuar. Procesi evidentohet në hapa të paracaktuar në këto pika të rregullores dhe zbatohet nga institucioni. [Evidenca 11, Dokumenti G. Rregullore për Burimet Njerëzore, pika GI8 dhe GI9]		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Infrastruktura e UET e pajisur me tre godina dhe rreth 7500 metra katrorë sipërfaqe krijon kushtet e nevojshme, të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. Personeli akademik ka zyra të veçanta dhe po ashtu edhe zyra mbledhjesh dhe takimesh. Në të tre godinat disponohen salla leksionesh, auditorë për seminarë, salla kompjuteri dhe laboratorë, të pajisur me infrastrukturën e nevojshme mësimore, të konfirmuara edhe gjatë vizitës fizike të GVJ. Zyrat që kryejnë funksionet mbështetëse, të tilla si Burimet Njerëzore, Biblioteka, etj janë të akomoduar në sallat e tyre përkatëse të pajisura



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>me infrastrukturën e nevojshme për një funksionim normal të aktiviteteve të tyre.</p> <p>[Evidenca 42.1 <i>Infrastruktura në funksion të programeve të studimit Rr. Xhanfize Keko</i>]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Programi i studimit mbulohet nga njësia bazë që është Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës. Ky Departament përbëhet nga 17 anëtarë PAE dhe 1 PAK, nga të cilët: 1 me titull profesor, 3 me titull profesor i asociuar, 4 doktor shkencash, 3 në proces doktorature dhe 6 me titull master.</p> <p>Strategjia e UET për vitet 2015-2020 dhe 2021-2025 parashikon plotësimin e misionit të tij nëpërmjet krijimit të një “ambienti relaksues por edhe nxitës” si për studentët ashtu edhe për stafin akademik. Në të gjithë pikat e vizionit të tij UET tregon angazhimin e tij në zhvillimin e mëtejshëm të stafit akademik. Po ashtu në Rregulloren e Burimeve njerëzore përfshihen çmime nxitëse për të rritur performancën e pedagogëve, si “pedagogu i vitit” etj. Për më tepër tek Strategjia e Kërkimit Shkencor, pjesa e objektivave strategjike pika 3 referon se Institucioni krijon një “mjedis stimulues” për kërkimin shkencor ku angazhohen si stafi ashtu edhe studentët.</p> <p>Në funksion të kualifikimit të vazhdueshëm të stafit akademik Institucioni ka ngritur strukturat e nevojshme që t’i përfshijë pedagogët në programe shkëmbimi Erasmus si dhe në projekte të kërkimit shkencor të Komunitetit Evropian. Po ashtu ka parashikuar dhe ka aplikuar mbështetje financiare për stafin që merr pjesë në konferenca dhe boton artikuj shkencorë. Institucioni ka krijuar shtëpinë e vet botuese dhe revistën e vet shkencore, si dhe organizon konferenca për të mbështetur zhvillimin e personelit të vet akademik.</p> <p>GVJ në takimin e kryer me personelin akademik u bë me dije edhe nga akademikët për mbështetjen financiare për konferenca dhe botime, siç parashikohet nga buxheti. Ky fond është shfrytëzuar plotësisht sipas konfirmimit të stafit akademik dhe i gjithë stafi ka pohuar se ka përdorur këto fonde në zhvillimin e vet akademik e personal.</p> <p>[Evidenca 3 <i>Plani Strategjik UET 2015-2020 3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017 – 2020, 3.2 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021 – 2025, 3.3 Plani Strategjik UET 2021-2025, Dokumenti G. Rregullore për Burimet Njerëzore</i>]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Siç përmendet edhe në RVB, por edhe nga vërtetimi i GVJ në takimin me stafin akademik, institucioni ka organizuar trajnime specifike që i përkasin aftësimin të përdorimit të programeve të ndryshme në funksion të mësimdhënies, sic është sistemi bazë LMS (Learning Management System). Në lidhje me metodat inovative të mësimdhënies duke e mbështetur stafin akademik në mobilitete, UET ju jep mundësinë për të aplikuar metodika të sjella nga universitete të tjera.</p> <p>[Evidenca 46.2 <i>Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS.pdf, 46.4 Video-trajnime mbi sistemin TEAMS_LMS.pdf</i>]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për</p>	<p>Sipas ligjeve në fuqi Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës planifikon kohën vjetore të punës sipas realizimit të procesit mësimor, kërkimit shkencor dhe transferimit të dijeve. Sipas evidencave të</p>

përbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.	dorëzuara për ngarkesën e stafit akademik për një vit akademik, stafi i angazhuar në programin Bachelor në Financë mbulon orë mësimore në auditor që vardojnë nga minimum 26 orë mësimore në maksimumin 289 orë mësimore për stafin PAE. Nga takimi me personelin akademik është përmendur se ngarkesa është e përbalueshme. [Evidenca 25. Ngarkesa mësimore në auditor e stafit akademik (aneks tab.4).pdf]		
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Infrastruktura e UET e pajisur me tre godina dhe rreth 7500 metra katrorë sipërfaqe krijon kushtet e nevojshme, të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen mësimdhënëse në mënyrë profesionale. Në të tre godinat disponohen salla leksionesh, auditorë për seminare, salla kompjuteri dhe laboratorë, të pajisur me infrastrukturën e nevojshme mësimore, të konfirmuara edhe gjatë vizitës fizike të GVJ. GVJ vizitoi mjediset e godinës dhe vërtetoi se ato plotësojnë normativat teknike të ndriçimit natyral dhe ishin të pajisura me sistem ngrohje. Biblioteka po ashtu ishte në një ambient të përshtatshëm me ajër dhe hapësira studimi të mjaftueshme. Numri i studentëve në të tre vitet në programin e studimit është 243 aktualisht dhe godinat përdoren në dy fasha orare. Nga takimi që GVJ pati me grupin e studentëve u shpreh si sugjerim që zhvillimi i mësimit në dy fasha orare të mos kryhet, pasi i pengon studentët në rast se janë të punësuar diku. [Evidenca 42.1 Infrastruktura në funksion të programeve të studimit Rr. Xhanfize Keko, Minutat e takimit me studentët]
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Klasat e godinave siç GVJ vërtetoi në vizitën e tij ishin të pajisura me pajisje kompjuterike stabël, tabela whiteboard dhe video projektor të lëvizshëm, të cilat mundësojnë zhvillimin e mësimit në kushte bashkëkohore. [Evidenca: Vizita e GVJ]
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat	UET ishte i pajisur me disa laboratorë me kapacitet 30 studentë dhe një laborator me kapacitet 60 studentë. Në këto laboratorë zhvilloheshin lëndë praktike që kërkojnë aplikimin e disa programeve të caktuara. UET, po ashtu përveç sallave të mbledhjeve kishte edhe ambiente teatri,

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	të gjitha të pajisura me teknologji moderne. Më shumë se një laborator përdorej për programin e studimit dhe të gjithë ishin të pajisur me programet e nevojshme për lëndët e PS si statistika, sisteme në kontabilitet etj. [Evidenca: Vizita e GVJ]			
Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.				
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Praktika profesionale në UET pas pandemisë aplikohet në auditor, duke përdorur sallat e nevojshme e duke sjellë profesionistë të fushës për mbajtjen e leksioneve dhe dhënie të informacionit nëpërmjet rasteve studimore. UET i përdor ambientet e veta edhe për qëllim të zhvillimit të praktikës mësimore si pjesë e programit mësimor, por jo për veprimtari të tjera praktike siç mund të jenë “hub”- et për start-ups. [Evidenca: Intervistë me Dekanin dhe Shefin e Departamentit, Minutat e Takimeve, Vizitë e GVJ në institucion.]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Institucionin disponon dhe vë në dispozicion bibliotekën për studentët e vet gjatë ditëve të javës në orarin 09:00 – 20:00 dhe të shtunën 09:00 – 17:00, ndërkohë gjatë periudhave të provimeve ka orar të zgjatur. Në këtë mënyrë ofrohet shfrytëzimi në mënyrë të barabartë nga të gjithë studentët. Biblioteka ka ambient të përshtatshëm, me hapësirë dhe dritë dhe disponon të gjithë mjetet teknologjike për të dhënë mundësinë e shfrytëzimit si të teksteve fizike ashtu edhe ato elektronike. Ajo ka rreth 170 vende studimi, duke ofruar mundësi të barabarta studimi për studentët. [Evidenca: 42. <i>Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit; Vizitë e GVJ në institucion, ëbsite i UET.</i>]
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra	Biblioteka është e pajisur me tekstet mësimore bazë dhe literaturën shtesë. Sipas informacioneve nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, ajo numëron një shifër prej 1707 tituj në disa gjuhë, që i shërbejnë programit të studimit Bachelor në Financë. Ndërkohë nga titujt totalë të disponueshëm në bibliotekë rreth 30% janë në gjuhë të

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>huaj. Vlen për t'u theksuar se një pjesë e mirë e literaturës së huaj është përkthyer nga UET Press duke bërë të mundur që tituj të autorëve me zë të disponohen gjithashtu edhe në shqip. Në bazë të evidencave, biblioteka disponon edhe tituj revistash e periodikësh në shqip dhe gjuhë të tjera. [Evidenca: 45. Inventari i teksteve në biblioteka për fushën e PS.pdf; Vizitë e GVJ në institucion; Takimi me akademikë dhe studentë.]</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka ofron akses edhe tek biblioteka online, përmes faqes së internetit. Përveç aksesit tek katalogu online "Opac", institucioni ka lidhje edhe me biblioteka të tjera si: Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë; COD – Biblioteka e Kryeministrit; Biblioteka e Kongresit – Amerikan; Biblioteka Kombëtare Gjermane; Biblioteka e Shangait; Biblioteka Shkencore e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Për kredencialet e aksesimit të portaleve studentët kontaktojnë përgjegjës të bibliotekës. Kështu krijohen kushte për akses të barabartë dhe pa pagesë për studentët. Nëpërmjet projekteve në të cilat UET ka marrë pjesë ka përfutur marrëveshje për akses në bibliotekat dixhitale, si: Sage & Ebsco, Social Science Library, EIFL (Electronic Information for Libraries) në platformat ASTM Compas & Elgar online. [Evidenca: website i UET, Vizitë e GVJ në institucion]</p>			
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Biblioteka përveç tavolinave të studimit, disponon edhe poste me programe kompjuterike për t'u përdorur nga studentët pa kufizime. Këto kompjuterë mundësojnë aksesin në bibliotekat online si dhe ofrojnë mundësi për të punuar me programe kompjuterike si office. [Evidenca: website i UET, Vizitë e GVJ në institucion]</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të Institucionit, biblioteka funksionon në bazë të një rregulloreje të brendshme, e cila përcakton qartë funksionin e bibliotekës, përdorimin e materialeve, detyrat e punonjës të bibliotekës dhe pasurimin e saj. Nëpërmjet procedurave në fuqi kryhet pasurimi i bibliotekës në mënyrë të përvitshme për t'i shërbyer procesit të mësimdhënies por edhe të kërkimit shkencor. [Evidenca: 45.1. Dokumenti E-IV. Mbi funksionimin e Bibliotekës. pdf; 45.2. E-IV-2 Formular për pasurimin e literaturës në biblioteka .pdf; 45.3. Shembull procedure_blerje literature. pdf]</p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Siç është përmendur edhe në kriterin 1 biblioteka zbaton orarin 09:00 – 20:00 gjatë ditëve të javës dhe të shtunën 09:00 – 17:00, ndërkohë gjatë periudhave të provimeve ka orar të zgjatur. Në këtë mënyrë ofrohet shfrytëzimi në mënyrë të barabartë nga të gjithë studentët.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Në përmbushje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>




Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Nga vizita e kryer në institucion, intervistat me pjesëmarrësit, vizita në sekretarinë mësimore dhe në ambientet e tjera të universitetit, GJV ka marrë dijeni se Institucioni disponon një sistem të përdorur nga të gjithë i quajtur LMS. Veçanërisht sektorë si Sekretaria Mësimore, Zyra IT dhe Zyra e Kurikulave dhe studentët përdorin edhe një sistem tjetër të quajtur UMIS. Është sqaruar se LMS përdoret si një platformë komunikimi për lëndët, materialet e tyre dhe vlerësimin, nëpërmjet pedagogëve dhe studentëve, ndërsa UMIS përmban të dhënat individuale të studentëve.</p> <p>[Evidenca: 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS.pdf; 46.1 Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS.pdf; 46.2 UET LMS - Guide per pedagogun .pdf; 46.3 UET_LMS_Guide për studentet. pdf; 46.4 Video-trajnime mbi sistemin TEAMS_LMS.pdf]</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemet UMIS dhe LMS janë projektuar për t'u aksesuar nga të gjithë pjesëtarët e personelit akademik dhe administrativ për të administruar informacionin e nevojshëm në kryerjen e detyrave që kanë. Për përdorimin e tyre stafi akademik është trajnuar dhe mund t'i referohet manualeve të ndryshme të përgatitura për këtë qëllim.</p> <p>[Evidenca: 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS.pdf; 46.1 Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS.pdf; 46.2 UET LMS - Guide per pedagogun. pdf; 46.3 UET_LMS_Guide për studentet. pdf; 46.4 Video-trajnime mbi sistemin TEAMS_LMS.pdf]</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Aksesi në sistemin e menaxhimit kryhet individualisht nga secili përdorues sipas profilit që ai ka dhe në lidhje me aksesin përkatës. Përdorues të ndryshëm kanë informacion specifik në informacione e dokumente të caktuara.</p> <p>[Evidenca: 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS.pdf; 46.1 Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS.pdf; 46.2 UET LMS - Guide për pedagogun.pdf; 46.3 UET_LMS_Guide për studentet.pdf; 46.4 Video-trajnime mbi sistemin TEAMS_LMS.pdf]</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi aktual mundëson komunikimin interaktiv midis personelit dhe studentëve, si për materialet mësimore, ashtu edhe në lidhje me regjistrimin në lëndë dhe notat e tyre.</p> <p>[Evidenca: 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS.pdf; 46.1 Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS.pdf; 46.2 UET LMS - Guide për pedagogun.pdf; 46.3 UET_LMS_Guide për studentet. pdf; 46.4 Video-trajnime mbi sistemin TEAMS_LMS.pdf]</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të</p>	<p>Sistemi aktual mundëson regjistrimin e aktivitetit të çdo përdoruesi dhe ofron mundësi të krijimit të raporteve të caktuara, që i shërbejnë organeve drejtuese të Institucionit.</p> <p>[Evidenca: 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS.pdf; 46.1</p>





dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	<i>Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS.pdf; 46.2 UET LMS - Guide për pedagogun.pdf; 46.3 UET_LMS_Guide për studentet.pdf; 46.4 Video-trajnime mbi sistemin TEAMS_LMS.pdf]</i>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Institucionin ka një faqe internet në të dyja gjuhët, shqip dhe anglisht ku përfshihet informacion tërësor në lidhje me programet, shërbimet, projektet, strukturat ndihmës-akademike, bibliotekën, eventet e organizuara dhe UET Press-in. [Evidenca: website i UET]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Në dokumentet e paraqitura nga institucioni përfshihet një raport përmbledhës për koston për student dhe një raport mbi të ardhurat dhe financimet për tre vitet e fundit. Edhe pse në raportin e brendshëm të Institucionit referohet se buxhetohen të ardhurat dhe kostot por nga Financa nuk është bërë i disponueshëm ndonjë dokument për projekt buxhetin, përveç pasqyrave financiare. Nga dokumentet e disponueshëm vihet re se burimet financiare të Institucionit janë kryesisht tarifat e studimeve, donacionet dhe të ardhura të tjera nga aktivitetet tregtare si qiradhënie. Referuar Statutit të UET, Kreu III, neni 19, pika 19.2.7.g Senati Akademik “jep mendimin e tij për projekt-buxhetin e UET” të përgatitur nga administrata, përpara se të miratohet nga Asambleja e Ortakeve. GVJ mendon se një proces me gjithëpërfshirës ku edhe Departamentet dhe Rektorati/Senati të marrë pjesë në përcaktimin e nevojave dhe miratimin e tyre është i domosdoshëm, dhe/ose nëse ekziston të evidentohet me një procedurë specifike të hartimit të këtij plani financiar. [Evidenca nr.: 2. Statuti i UET.pdf; 49. të dhëna mbi koston për student.pdf; 50. të ardhura dhe financime të ndryshme; 50.1 Pasqyrat Financiare 2018 me shënime.pdf; 50.2 Pasqyrat Financiare 2019 me shënime.pdf; 50.3 Pasqyrat Financiare 2020 me shënime.pdf;]
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e	Në pasqyrat financiare (jo në planin e financimit) paraqiten të gjitha burimet e të ardhurave dhe kostot të ndara në baze të llojit të tyre. Aty përfshihen të ardhura nga aktiviteti kryesor dhe dytësor. Në raportin e të ardhurave nga financime të ndryshme identifikohen edhe burimet e të ardhurave të Institucionit. Ndërsa për sa i përket shpenzimeve ato grupohen në shpenzime të personelit, shpenzime konsumi dhe



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grandet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>amortizime dhe shpenzimet të tjera shfrytëzimi. GVJ mendon se hartimi i një plani financiar gjithëpërfshirës do të bëjë të mundur të analizoje të gjithë të ardhurat dhe shpenzimet sipas natyrës së tyre specifike.</p> <p><i>Evidenca nr. 50. të ardhura dhe financime të ndryshme; 50.1 Pasqyrat Financiare 2018 me shënime.pdf; 50.2 Pasqyrat Financiare 2019 me shënime.pdf; 50.3 Pasqyrat Financiare 2020 me shënime.pdf;]</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Institucioni ka kryer auditime të përvitshme nëpërmjet të cilave evidenton gjendjen financiare, dhe raportet e efektivitetit. Pasqyrat financiare përmbajnë informacion të hollësishëm mbi të ardhurat dhe shpenzimet dhe shoqërohen me shënime të cilat analizojnë fitueshmërinë, efektivitetin dhe vazhdueshmërinë e institucionit. Po ashtu raporte nga auditues të jashtëm përpilohen në lidhje me raportet financiare. <i>GVJ vëren ndryshim të audituesit për vitin 2020. Theksojmë se audituesi i pavarur për vitin 2019 ka lëshuar një opinion me rezervë në lidhje me humbjet e njohura nga zhvlerësimi i aktiveve afatgjata të cilat mund të dëmtojnë vijueshmërinë e institucionit në të ardhmen. Gjithsesi në vitin vijues, Institucioni është paraqitur me fitime.</i></p> <p><i>[Evidenca nr. 50.1 Pasqyrat Financiare 2018 me shënime.pdf; 50.2 Pasqyrat Financiare 2019 me shënime.; 50.3 Pasqyrat Financiare 2020 me shënime.pdf; 50.4 Raport auditimi viti 2018.pdf; 50.5 Raport auditimi viti 2019.pdf; 50.6 Raport auditimi viti 2020.PDF;]</i></p>			
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Përveç vitit 2019, ku është paraqitur me humbje Institucioni ka dëshmuar ndër vite se të ardhurat e tij janë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e për të gjeneruar fitime. Shënojmë se këto të ardhura, gjithsesi kanë ardhur në ulje dhe se duhet të merren masa për të siguruar vijueshmërinë e Institucionit në rast se kjo tendencë vazhdon edhe në të ardhmen.</p> <p><i>[Evidenca nr. 50.1 Pasqyrat Financiare 2018 me shënime.pdf; 50.2 Pasqyrat Financiare 2019 me shënime.; 50.3 Pasqyrat Financiare 2020 me shënime.pdf; 50.4 Raport auditimi viti 2018.pdf; 50.5 Raport auditimi viti 2019.pdf; 50.6 Raport auditimi viti 2020.PDF;]</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Përveç vitit 2019, ku është paraqitur me humbje Institucioni ka dëshmuar ndër vite se të ardhurat e tij janë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e për të gjeneruar fitime. Shënojmë se këto të ardhura, gjithsesi kanë ardhur në ulje dhe se duhet të merren masa për të siguruar vijueshmërinë e Institucionit në rast se kjo tendencë vazhdon edhe në të ardhmen.</p> <p><i>[Evidenca nr. 50.1 Pasqyrat Financiare 2018 me shënime.pdf; 50.2 Pasqyrat Financiare 2019 me shënime.; 50.3 Pasqyrat Financiare 2020 me shënime.pdf; 50.4 Raport auditimi viti 2018.pdf; 50.5 Raport auditimi viti 2019.pdf; 50.6 Raport auditimi viti 2020.PDF;]</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës IV	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X



V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Institucioni ka hartuar politikat mbi procesin e pranimit të studentëve dhe deri në dalje të tyre dhe i ka dokumentuar ato me procedura specifike në bazë të legjislacionit dhe të akteve rregullatore. Këto dokument përfaqësojnë informimin dhe ndërgjegjësimin, kriteret e pranimit, dokumentacionin e kërkuar për regjistrim, procedurën e pranimit për programet e ciklit të dytë dhe të tretë.</p> <p>[Evidenca nr. 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studenteve.pdf; 27.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik.pdf; 48. Dokumenti E.V. Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online.pdf; 15. Modeli i Diplomës dhe suplementi sipas profileve.pdf; 32.1 Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale.pdf]</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Të gjitha politikat dhe procedurat e përmendura më lart janë përpiluar me qëllim garantimin e barazisë në marrjen e informacionit, konkurrimin, studimin dhe diplomimin e studentëve.</p> <p>[Evidenca nr. 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studenteve.pdf; 27.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik.pdf; 48. Dokumenti E.V. Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online.pdf; 15. Modeli i Diplomës dhe suplementi sipas profileve.pdf; 32.1 Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale.pdf]</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Të gjitha procedurat dhe kriteret e pranimit e të përzgjedhjes së studentëve janë të kuptueshme, të akseueshme nga publiku nëpërmjet faqes së internetit ose materialeve të marketingut të printuara e të disponueshme nëpër panaire, promovime apo në ndërtesat e Institucionit.</p> <p>[Evidenca nr. 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studenteve.pdf; 27.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik.pdf; 48. Dokumenti E.V. Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online.pdf; 15. Modeli i Diplomës dhe suplementi sipas profileve.pdf; 32.1 Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale.pdf; Ëbsite UET]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të</p>	<p>Në bazë të legjislacionit në fuqi dhe të akteve normative ligjore si dhe të procedurave të brendshme Institucioni harton dhe publikon të gjitha kriteret e nevojshme për pranimin e kandidatëve në ciklin e studimeve. Këto gjenden të publikuara edhe në faqen e internetit të Institucionit.</p> <p>[Evidenca nr. 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

studimeve.	<i>e pranimit të studenteve.pdf; Eëbsite UET]</i>			
Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Sipas politikave dhe kriterëve për procesin e pranimit të cilat janë në përputhje me ligjet, pika D.I.2.2 parashikohen edhe regjistrimi i studentëve të huaj <i>[Evidenca nr. 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studenteve.pdf;]</i>			
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Çdo vit Institucioni bë të ditur të publiku të gjithë kriteret e pranimit në programet e tij. Ky komunikim kryhet në mënyra të ndryshme: panaire, takime specifike, faqja e internetit dhe rrjete sociale, ndërtesa e Institucionit dhe nëpërmjet fushatave të marketingut në televizione dhe radio. <i>[Evidenca nr. 48. Dokumenti E.V. Politikën e prezantimit dhe promovimit të UET online.pdf; Website UET]</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Rregullorja e programit të studimit përmban të gjithë informacionin e nevojshëm të studentit që pranohet në programin për përparimin e tij akademik, të drejtat dhe detyrimet. Në këtë rregullore përfshihen hollësisht kriteret e pranimit, Struktura e programit të studimit, objektivat, kohëzgjatja, kreditet dhe kontrolli i dijeve, frekuentimi, transferimi, praktika profesionale dhe diplomimi. <i>[Evidenca nr. 7. Rregullore e PS BA Finance (Shqip).pdf]</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Institucioni disponon një procedurë të veçantë në lidhje me transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin. Kriteret e kësaj procedure bëhen të njohura tek studentët sipas interesit që ata kanë nëpërmjet strukturës së Zyrës së Kujdesit ndaj studentit. Dokumenti përfshin informacion të detajuar në lidhje me transferimin dhe njohjen e krediteve, parimet e njohjes, Komisionin e Njohjes, Vlerësimin e lëndëve etj. <i>[Evidenca nr. 28. Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin.pdf]</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në	Përveç rregullores së PS, dhe dokumentit të sistemit të vlerësimit të dijeve, çdo syllabus përmban kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve sipas aftësive të studentëve, tek seksioni “Forma e Kontrolli i dijeve”.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



programin e studimit.	[Evidenca nr. 7. Rregullore e PS BA Finance (Shqip).pdf; 19.1 Formatimi i Syllabusit (shqip anglisht).pdf; 7.1. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve.pdf]			
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Institucioni ka një procedurë të veçantë në lidhje me kriteret e punimit të disertacionit për të gjithë ciklet e studimit, ku parashikohet qartë procesi dhe dokumentacioni i nevojshëm deri në diplomim. Kjo procedurë përfshin detaje në lidhje me përzgjedhjen e temës, të udhëheqësit si dhe të çdo hapi në komunikimin midis studentit e udhëheqësit, e duke përfshirë po ashtu edhe mënyrën e shkrimit e të përfundimit të saj. [Evidenca nr. 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.pdf]			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Institucioni ka një politikë të qartë marketingu në lidhje me programin në të cilën përfshihet përdorimi i të gjithë metodave për të informuar të interesuarit për programin e studimit, përfshirë publikime, takime, evente, reklama etj. [Evidenca nr. 51. Politika e Marketingut e programit të studimit.pdf]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Zyra e Kujdesit ndaj studentit është pika e parë e takimit të studentëve të rinj me Institucionin. Kjo Zyrë informon hollësisht studentët në lidhje me programin, strukturën dhe lëndët. Po ashtu në dispozicion të studentëve është edhe rregullorja e PS. Dhe në vijim në momentin e regjistrimit dhe të fillimit të vitit akademik, Institucioni parashikon kontaktin me këshilluesin akademik. i gjithë informacionin në lidhje me programin disponohet gjithashtu në faqen e internetit të Institucionit. [Evidenca nr. 12. Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf; nr. 7. Rregullore e PS BA Finance (Shqip).pdf; 27.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik.pdf;]
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët,	Institucioni ka si praktikë përgatitjen e sillabuseve për secilën lëndë, të cilat çdo pedagog i vë në dispozicion të studentit në fillim të vitit akademik në auditor, por edhe në sistemin e komunikimit pedagog-student LMS. Silabusi përfshin në mënyrë të detajuar përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të lëndës. GVJ sugjeron krijimin e një "prospectusi" për programin ku të

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

përbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	përfshihen të gjitha lëndët e programit së bashku e të ofrohet si një dokument sqarues tek studentët. [Evidenca nr. 7. Rregullore e PS BA Finance (Shqip).pdf; 19.1 Formati i Syllabusit (shqip anglisht).pdf;			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Zyra e Këshillimit të Karrierës është përgjegjëse për të informuar studentët mbi mundësitë e punësimit dhe orientimit drejt tregut të punës. Nga vizita e GVJ dhe informacionin i marë nga Zyra përkatëse, kjo zyrë mundëson komunikimin e vazhdueshëm me studentët për mundësi punësimi ose mundësi praktikash profesionale që mund të udhëzojnë drejt punësimit. [Evidenca nr. 12. Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf;]			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Përveç sistemit LMS i cili i mban në kontakt studentët me çdo material të lëndës dhe procesin mësimor, Departamenti ngarkon koordinatoren me detyrën për të qenë në kontakt të vazhdueshëm me studentët dhe nevojat e tyre. Si GVJ u informua, kontakti direkt me përfaqësues të studentëve bëhet edhe nga strukturat më të larta të Rektoratit për të diskutuar e përmirësuar aspektin mësimor. [Evidenca: Takimi me studentët, Departamentin]			
Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	Sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit bën të mundur aksesin e të gjithë studentëve me materialet mësimore dhe arritjet e tyre në çdo rast. Evidenca: Takimi me studentët]			
Shkalla e përbushjes së standardit	përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.4
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	Nga vizita e GVJ në Sekretarinë mësimore si dhe nga takimet me përfaqësues të Institucionit, ai disponon një sistem të posaçëm për mbajtjen e numrit të studentëve dhe ecurinë e tyre, përveç regjistrave të detyrueshëm sipas ligjit. Institucionin krijon raporte për monitorimin e numrit të studentëve për çdo program studimi, përfshirë PS në Financë. Sistemi UMIS siguron "4 eyes principles" në hedhjen dhe monitorimin e të dhënave. PO ky sistem siguron statistika vjetore për largimet, transferimet, përfundimet ose jo të programit studimor. Nga kërkesat që GVJ pati në lidhje me statistikat e studentëve ato u vunë në dispozicion të plota dhe në kohë.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	[Evidenca 27. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin.pdf; 5. Të dhëna për numrin e studentëve të regjistruar në Master sipas profileve.pdf; 2. Të dhëna për studentët që kanë mbaruar BA Financë dhe kanë vijuar ciklin e dytë Master në UET.pdf]			
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.	Nga takimi në Sekretarinë Mësimore GVJ u bë me dije në lidhje me zhvillimin e programit të studimeve, mbajtjen e rekordeve të studentëve dhe përditësimin e të dhënave të ecurisë së tyre. Në një përzgjedhje të rastësishme u evidentua një proces verbal notash, i cili përbëhej nga dy fletë. Në fletën e parë ishte nota përfundimtare, ndërsa në fletën poshtë pikët përmbledhëse për çdo pjesë të lëndës. Po ashtu U kontrollua Regjistri Themeltar i Studentëve dhe i Notave për nivelin Bachelor si dhe u verifikuan disa procedura Transferimesh. Të gjithë procedurat ishin konform rregullores.			
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	[Evidenca: Takimet e GVJ në Sekretarinë Mësimore, Minutat e takimeve]			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Institucioni ka hartuar dhe ka vënë në dispozicion raporte analitike në lidhje me cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe evidence të tjera të prodhuara nga sistemi i brendshëm i informacionit. [Evidenca 27. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin.pdf.]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Standardi V.5 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Referuar Statutit të UET neni 51, Institucioni parashikon organizimin e studentëve nëpër Këshillat Studentorë me qëllim pjesëmarrjen e tyre në qeverisjen e universitetit dhe përfaqësimin në organet drejtuese të Institucionit. Tre prej organeve drejtuese: Senati Akademik, Këshilli i Etikës dhe Komisioni i Sigurimit të Brendshëm kanë një përfaqësues të studentëve. [Evidenca 2. Statuti i UET.pdf]			
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të	Me urdhër administrativ UET përcakton dhe garanton përfshirjen e studentëve në organet drejtuese dhe vendimmarrëse. Institucioni i përfshin studentët edhe në vlerësimin e procesit dhe cilësisë së mësimdhënies, nëpërmjet pyetësorëve si instrumente të sigurimit të cilësisë, por edhe nëpërmjet krijimit të të ashtuquajturave “focus” grupeve. [Evidenca nr. 30.4. Urdhër administrativ mbi përbërjen e KSBC.pdf ;			




verifikueshme e të matshme.	<i>Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf; 40. G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët.pdf</i>		
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Referuar rregullores së PS, neni 5.6, institucioni parashikon ngarkesën akademike të studentëve dhe përparimin e tyre në bazë të plotësimit të numrit të krediteve. Neni 9 i po së njëjtës rregullore parashikon transferimet e lëndëve nga programe të mëparshme. Procedurat e parashikuara janë të lehta dhe joburokratike. <i>[Evidenca nr. 7. Rregullore e PS BA Finance (Shqip).pdf; 28. Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin.pdf]</i>		
Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Sipas rregullores së SBC, pika F.VII.7.2 një përfaqësues i Këshillit Studentor duhet të jetë pjesë e Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë. Ndër detyrat kryesore të këtij Komisioni është sigurimi i cilësisë në mësimdhënie nëpërmjet sugjerimeve që studentët ofrojnë nga plotësimi i pyetësorëve. Pyetësorët janë instrumenti bazë që përdoret për të marrë sugjerimet e nevojshme nga baza studentore. Po ashtu në të njëjtën rregullore parashikohen edhe “focus” grupet të cilat janë intervista me grupe të vogla studentësh në lidhje me vlerësimin e tyre për programet, për pedagogët dhe sugjerimet që ata kanë si kontribut praktik dhe i matshëm në procesin e përmirësimeve të programeve. Nga takimi i GVJ me Departamentin, por edhe nga takimi me studentët u shpreh se “focu” grupet kanë ndihmuar në përmirësimin e programeve dhe sugjerimet e studentëve janë marrë parasysh. <i>[Evidenca nr. 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf; 40. G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët.pdf]</i>		
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	GVJ gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore ka konstatuar një proces të qartë në lidhje me vlerësimin e kontrollit të dijeve dhe ankimit të rezultetit. Rregullorja e PS, neni 5.8; rregullorja e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve, sillabuset dhe procesi në fuqi i ankimit i jep mundësinë studentëve të vlerësojnë barazinë, transparencën dhe ndershmërinë e procesit. Studentët mund të ndjekin edhe procedurën e ankimit në rast se vërejnë padrejtësi ose pabarazi. <i>[Evidenca nr. 7. Rregullore e PS BA Finance (Shqip).pdf; 7.1. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve.pdf; 19.1 Formati i Syllabusit (shqip anglisht).pdf; 40.1 D-VI-3-3 Formular per ankesat e studenteve.pdf]</i>		
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret**Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.

Institucioni ka ngritur një strukturë të posaçme të quajtur Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit e cila ka si funksion primar të informojë dhe këshillojë rreth mundësive të studimit. Kjo Zyrë ofron shërbimet e saj tek studenti në hyrje dhe orientim gjatë semestrit të parë, por edhe përgjatë gjithë viteve të studimit, duke këshilluar e informuar studentët në çdo hap. Nga takimi i GVJ me studentët ata përveç kësaj strukture ju referuan gjithashtu edhe strukturave të vetë Departamentit dhe këshilluesve akademikë, veçanërisht drejtuesit të Departamentit që i udhëzon në çdo hap të karrierës së tyre studentore.

[Evidenca nr. 12. Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf]

Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.

Sistemi i këshillimit në UET, siç u përmend edhe tek kriteri 1 më sipër përfshin Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, të mbështetur nga strukturat e këshillimit në Departament dhe nga Sekretaria dhe njësitë e tjera administrative. Kjo Zyrë, ka 4 të punësuar dhe sipas pikës E.VII.2 kujdeset veçanërisht për:

- a. qeverisjen dhe aktivitetet e studentëve, programet e ndryshme të lidërshipit të studentëve dhe eventet speciale të mëdha në kampus.
 - b. Klubet dhe organizimet e studentëve
 - c. Qeverinë studentore
 - d. Shkollat stimore për studentët;
 - e. Trajnime online të studentëve për çështje të ndryshme;
 - f. Programet e para-orientimit, bëhen përpara programit të orientimit të studentëve të rinj (gjimnaz tour dhe UET-tour)
 - g. Family weekend;
 - h. Kalendarit eventeve;
 - i. Politika dhe formularë;
 - j. Ankesat e studentëve – formale dhe konfidenciale;
 - k. Burimet elektronike të përdorura nga studentët (adresa elektronike dhe LMS);
 - l. Organizimi financiar dhe rregullat e mbledhjes së parave cash;
 - m. Tarifat dhe pagesat për shërbime të ndryshme;
 - n. Pyetjet më të shpeshta (përgjigjet për to);
- ZKS ka për detyrë të ndërtojë një mënyrë komunikimi dhe informimi me studentët, përmes të cilës ata mund të gjejnë orare, pedagogë, dhe rregulla të hyrjes dhe qëndrimit në klasë, si dhe t'i orientojnë në:

- a. aplikimin on line për bursat;
- b. aplikimin për bursa Erasmus, projekte, intershipe dhe punësim.”

[Evidenca nr. 12. Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf]

Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për

Sipas rregullores në fuqi të Zyrës përkatëse, pikat E.VII.4, E.VII.5, E.VII.6, “Zyra e Këshillimit të Karrierës e zhvillon aktivitetin e saj në bashkëpunim të ngushtë me këshilluesit e karrierës së çdo

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>fakulteti/departamenti, si dhe duke u diferencuar në funksion të nivelit të studimit”. Ata kanë një databazë me të gjithë studentët me të cilët komunikojnë elektronikisht për t’i këshilluar nga lidhje me vende pune, përgatitjen e CV-ve apo letrave të motivimit, përgatitjen për intervista etj. Kjo zyrë mban vazhdimisht kontakt edhe pas largimit të studentëve nga UET, por edhe me punëdhënësit e ish-studentëve të UET nga të cilët merr informacion në lidhje me cilësinë e të diplomuarve. Punëdhënësit janë kryesisht Banka. Këtë vit në qershor UET organizon edhe Festivali i Alumni-t sic GVJ u informua nga takimi me përfaqësues të Zyrës. Nga i njëjti takim po ashtu u përmend se përçindja e punësimit është ulur kryesisht prej pandemisë. Kjo zyrë po ashtu zhvillon panairt e punës dhe mban vazhdimisht kontakt me të gjitha palët në rast eventesh por edhe në rast përfshirje në procese të UET.</p> <p>[Evidenca nr. 12. Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf; Minutat e takimeve, takimi me ZKKKS; 12.2. Poster Panairi i Punës 2018 dhe 2019.pdf]</p>								
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Siç u përmend edhe më lart kjo Zyrë ndjek studentët edhe pas diplomimit duke mirëmbajtur databazën me të dhëna për alumnit dhe punësimin e tyre. Po ashtu është përmendur se një pjesë e alumnive janë po ashtu edhe anëtarë të Bordit të Punës apo marrin pjesë në Komisionet e UET.</p> <p>[Evidenca nr. 12. Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf; Minutat e takimeve, takimi me ZKKKS; Evidenca nr. 29. Tabele permbledhese per punësimin real të studenteve.pdf]</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="606 1120 742 1198">Niveli i përmbushjes</th> <th data-bbox="750 1120 949 1198">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="957 1120 1157 1198">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1165 1120 1388 1198">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="606 1198 742 1265"></td> <td data-bbox="750 1198 949 1265"></td> <td data-bbox="957 1198 1157 1265"></td> <td data-bbox="1165 1198 1388 1265">X</td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<p>Standardi VI.1</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për</p>	<p>Sipas statutit të UET, neni 11, pika 11.1 institucioni parashikon hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin brendshëm dhe të</p>



Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>jashtëm të cilësisë sipas akteve ligjore e nënligjore. Institucioni ka ngritur Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë e cila ka si detyrë të sigurojë cilësinë në gjithë veprimtarinë e UET, nëpërmjet vlerësimit periodik të rezultateve dhe veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore dhe krijimit të Raporteve Përkatëse që dëshmojnë këto rezultate e japin mundësi për mirësimi. [Evidenca nr. 2. Statuti i UET.pdf]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Institucionin e ka funksional sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë nëpërmjet strukturës së ngritur ku përfshihen autoritetet drejtuese të UET, Zyra e Standardeve dhe Cilësisë dhe Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë. Nga vizita me përfaqësues të Zyrës është përmendur se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kjo Zyrë u krijua në 2017 dhe është plotësisht funksionale. - Zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. - Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC) e ka filluar punën që me krijimin e institucionit (2011) dhe vepron në nivel institucional - Monitoron dhe vlerëson periodikisht veprimtarinë mësimore dhe kërkimore në institucion. - Brenda kësaj njësie funksionon edhe Zyra e Standardeve dhe Cilësisë (ZSC), e cila zhvillon politika, strategji, udhëzime në funksion të rritjes së cilësisë, si dhe monitoron zbatueshmërinë e tyre nga njësitë akademike dhe administrative. - Njësia bashkëpunon me stafin akademik, administrative, studentë, anëtarë të Bordit të Tregut të Punës, me ASCAL dhe me struktura të ndryshme shtetërore. - Monitoron zbatimin e rasteve të studentëve me transferime. - Harton dhe organizon pyetësorë me studentët për çdo pedagog dhe për çdo program studimi (kemi vërejtur se nuk organizohet për çdo lëndë), me anëtarët e Bordit të Tregut të Punës. Sipas rregullores së sigurimit të cilësisë, Komisioni i përhershëm ngrihet nga Rektori dhe miratohet nga Senati dhe përfshin: Kryetarin, një përfaqësues nga pedagogët e secilit Fakultet, një përfaqësues nga personeli ndihmës-akademik ose administrative, një përfaqësues nga Këshilli Studentor, dhe të paktën një përfaqësues ekspert i jashtëm. <p><i>Evidenca nr. 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf; Minutat e takimit, Takimi me përfaqësues të Sigurimit të Cilësisë; 30. Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e</p>	<p>Institucioni i nënshtrohet akreditimeve periodike për sigurimin e cilësisë së programeve të tij, sipas rregulloreve në fuqi, ligjeve dhe akteve normative. Akreditimet janë në nivel institucional dhe në nivel program siç kërkon ligji. Institucioni ndjek të gjithë hapat e nevojshëm dhe proceset për vetëvlerësimin dhe vlerësimin e jashtëm duke lehtësuar ekspertët me informacionin e vënë në dispozicion. Institucioni ndjek me një plan të qartë hapat për përmbushjen e rekomandimeve të vlerësimeve të jashtme periodike dhe raporton në ri-vlerësimin e radhës.</p>

përmirësojnë cilësinë.				
Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	Institucioni ka hartuar strategji për sigurimin e cilësisë, manual për sigurimin e brendshëm të cilësisë, dhe plan veprimi për KSBC. Të gjitha këto përpjekje janë në funksion të rritjes së cilësisë së programeve dhe të krijimit të kulturës në rritje të cilësisë. [30.1. Plani veprimit KSBC; 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf; 30.3 Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf; 30.4. Urdhër administrativ mbi përbërjen e KSBC.pdf]			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2


Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	Ne baze të rregullores se UET, Kreu II STRUKTURA ORGANIZATIVE, Neni 6 Njësitë ndihmëse mësimore dhe administrative, pika 6.1 Njësitë kryesore ndihmëse mësimore dhe administrative, nën-pika 2. Standardet dhe Cilësia, përfshihen: a. Zyra e Standardeve dhe Cilësisë b. Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC) vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore-shkencore, të UET-it. Mënyra e ngritjes dhe funksionimit të tij rregullohet me dokument të veçantë. c. Zyra e Burimeve Njerëzore d. Zyra e Kurrikulave. Sipas dokumentit mbi Funksionim e Zyrës së Kurrikulave, ajo "koordinon punën me Departamentet për zhvillimin e kurrikulave ekzistuese, në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe legjislacionit në fuqi, ashtu edhe vlerëson propozimet për hapjen e programeve të reja, riorganizimin, përshtatjen ose mbylljen e programeve ekzistuese, për nga përputhshmëria me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe aktet rregullatore të UET. Zyra mbështet departamentet me konsulentë në lidhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, dhe parimet e kriteret e vendosura nga UET në lidhje me hartimin dhe ndryshimin e kurrikulave." [Evidenca nr. 5. Rregullore e UET.pdf; 13. Dokumenti E.VIII Mbi funksionimin e Zyres se Kurrikulave.pdf]
Kriteri 2. Institucioni përdor	Sipas rregullores mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave, kjo është

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.

përgjegjëse për funksionet si më poshtë:

- a. Ndjek përgatitjen e programeve të reja të studimit për të tri ciklet e studimit, si edhe programet me karakter profesional;
- b. Shqyrton propozimet për rishikimin periodik të programeve të licencuara që ofrohen në UET;
- c. siguron përputhshmërinë e kurrikulës me kërkesat e legjislacionit për arsimin e lartë;
- d. vlerëson propozimet për hapjen e programeve të reja të studimit, ndryshimin ose riorganizimin e programeve ekzistuese, etj.
- e. mbledh programet e lëndëve të ofruara në secilin cikël studimi, verifikon respektimin e formatit dhe të parimeve të përcaktuara për hartimin e tyre;
- f. mbështet Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për përgatitjen e raporteve për vlerësime të programeve të studimit, si për qëllim akreditimi, ashtu edhe për rastet e hapjes së programeve të reja, për çështje të kurrikulave dhe të atyre me karakter mësimore-kërkimor”.

UET po ashtu përdor instruksione edhe për sigurimin e cilësisë që në gjeneze të ndërtimit të programit, siç është dokumenti “mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndes”, të sillabusit nëpërmjet dokumentit format sillabusi, raportet vjetore etj, si dhe procedura për ndryshimin e kurrikulës.

[Evidenca nr. 13. Dokumenti E.VIII Mbi funksionimin e Zyres se Kurrikulave.pdf 39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndes.pdf; 52. Procedura për ndryshimin e kurrikules BA Finance (Tabela 11).pdf]

Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.

Sipas manualit të sigurimit të cilësisë, pika 2.4 dhe planit të veprimit KSBC, Institucioni përdor disa metoda vlerësimi për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve. Më poshtë paraqiten llojet e vlerësimit dhe instrumentet për secilin që përfshijnë:

1. Vlerësimin e sillabuseve; (30.7 Shpërndarja e relacionit të KSBC mbi sillabuset.pdf)
2. Pyetësi online i studentëve; (40. G-III-4-2 Format i vlerësimit të pedagogut nga studentët.pdf)
3. Monitorimi procesit të notave; (30.6 Format raporti për provimet.pdf)
4. Vlerësim i punëve kërkimore-shkencore; (43. të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit.pdf)
5. Vlerësim i përfshirjes së studentëve në punët kërkimore; (59. të dhëna për angazhimin e studenteve në projekte dhe KSH.pdf)
6. Pyetësi i fokus-grupeve
7. Përfshirja e studentëve në vendimmarrje (30.4. Urdhër administrativ mbi përbërjen e KSBC.pdf)
8. Orët e tutoriatit dhe këshillimit akademik (27.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik.pdf)
9. Trajtimi i ankesave të studentëve (40.1 D-VI-3-3 Formular për ankesat e studenteve.pdf.)
10. Vetëvlerësimi i stafit akademik dhe vlerësimi nga eprori i

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>stafit akademik (41. G-I-12-1 Formular i vetëvlerësimit të performancën së personelit akademik.pdf; 30.8. G-III-4-1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu.pdf)</p> <p>Të gjithë instrumentet e mësipërme shërbejnë për të matur, monitoruar e raportuar mbi cilësinë dhe mbarëvajtjen e programeve dhe sigurimin e cilësisë së ofruar nga këto programe.</p> <p>[Evidenca nr. 30.1. Plani veprimi KSBC; 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf]</p>			
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Të gjithë rezultatet nga përdorimi i instrumenteve të përmendura në kriterin 3 më sipër grupohen në raporte dhe ju bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p> <p>[Evidenca nr. 30.1. Plani veprimi KSBC; 38. Analiza e DEF mbi arritjen e objektivave formuese.pdf]</p>			
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Raportet e vlerësimit përfshijnë analizën e arritjeve kundrejt objektivave dhe ndiqen nga KSBC për plotësimin e tyre. Sipas planit të KSBC përpilohet një raport vjetor, <i>por ky i fundit nuk është pjesë e dokumentacionit nga Institucion. GVJ po ashtu vëren që një pjesë e dokumentacionit të Sigurimit të Cilësisë vjen si produkt i projektit QAINAL, por nuk është përshtatur/ndërlidhur me dokumentacionet që Institucioni përdor, duke i lënë të shpërndara informacionet nga relacione të veçanta.</i></p> <p>Një praktikë e një analize ankese nga studentët është vënë në dispozicion nga dokumentacioni shtesë.</p> <p>[Evidenca shtesë nr. 4. Praktikë e analizimit të ankesave të studentëve - evidencat.pdf]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	
<p>Standardi VI.3</p> <p>Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve</p>				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Vlerësimi i brendshëm i programit kryhet periodikisht nga Departamenti i cili e ofron këtë program, nëpërmjet një analize të detajuar mbi arritjen e objektivave formuese të programit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësisimit Professional. Ky raport përfshin analizën e cilësisë në hyrje dhe dalje, kalueshmërinë e studentëve, kurrikulën e programit dhe stafin akademik, informacion mbi praktikën profesionale dhe mbrojtjen e diplomave, si dhe aktivitetet e Departamentit.</p> <p><i>GVJ mendon se në këtë raport duhet të përfshihen edhe të dhëna në lidhje me pyetësorët online ose të fokus grupeve në lidhje me programet e studimit, nëse ka patur rishikim të kurikulës, cili ka qenë angazhimi i studentëve, sa është numri i studentëve që ë frekuenton dhe c'farë rezultatesh ata kanë, si dhe sugjerime në lidhje me programin e studimit.</i></p>			

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


Web site: www.ascal.al

	<p>Përveç këtij raporti, Departamenti rishikon cilësinë e programit edhe nëpërmjet raporteve periodike të akreditimit, ku një grup pune vetëvlerëson ecurinë e programit në të gjithë aspektet. <i>[Evidenca nr. 38. Analiza e DEF mbi arritjen e objektivave formuese.pdf; raporte të mëparshme të akreditimit]</i></p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Për vlerësimin e cilësisë së programit Institucioni përdor instrument dhe metodologji të ndryshme, si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësimin e sillabuseve; (30.7 Shpërndarja e relacionit të KSBC mbi sillabuset.pdf) 2. Pyetësi online i studentëve; (40. G-III-4-2 Format i vlerësimit të pedagogut nga studentët.pdf) 3. Monitorimi procesit të notave; (30.6 Format raporti për provimet.pdf) 4. Vlerësim i punëve kërkimore-shkencore; (43. të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit.pdf) 5. Vlerësim i përfshirjes së studentëve në punët kërkimore; (59. të dhëna për angazhimin e studenteve në projekte dhe KSH.pdf) 6. Pyetësi i fokus-grupeve 7. Përfshirja e studentëve në vendimmarrje (30.4. Urdhër administrativ mbi përbërjen e KSBC.pdf) 8. Orët e tutoriatit dhe këshillimit akademik (27.2. Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik.pdf) 9. Trajtimi i ankesave të studentëve (40.1 D-VI-3-3 Formular për ankesat e studenteve.pdf.) 10. Vetëvlerësimi i stafit akademik dhe vlerësimi nga eprori i stafit akademik (41. G-I-12-1 Formular i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik.pdf; 30.8. G-III-4-1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu.pdf) <p><i>[Evidenca nr. 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Si metoda të veçanta të vlerësimit të drejtpërdrejtë përdoren:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Pyetësi online i studentëve; (40. G-III-4-2 Format i vlerësimit të pedagogut nga studentët.pdf) 2. Monitorimi procesit të notave; (30.6 Format raporti për provimet.pdf) 3. Pyetësi i fokus-grupeve <p><i>[Evidenca nr. 30.2. Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf]</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të</p>	<p>Në kuadër të mbarëvajtjes së cilësisë, Institucioni përdor edhe</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al






<p>vlerësimin të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.</p>	<p>instrument të tërthorta si:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësimi nga eprori i stafit akademik (30.8. G-III-4-1 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu.pdf) 2. Intervista e sondazhe të ndryshme nga të diplomuar siç referohet në raportin e brendshëm. 3. Marrjen e informacioneve nga Bordet e Tregut të Punës në lidhje me programet dhe cilësinë e tyre. <p><i>GVJ nuk ka mundur të identifikojë dokumentacionin përkatës në lidhje me sondazhet.</i></p>		
	<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>
		X	

<p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Sipas dokumentit mbi sigurimin e cilësisë, në Komisionin e përhershëm për sigurimin e cilësisë përfshihen aktorë të brendshëm dhe ekspertë të jashtëm. Sipas rregullores se sigurimit të cilësisë, Komisioni i përhershëm ngrihet nga Rektori dhe miratohet nga Senati dhe përfshin: Kryetarin, një përfaqësues nga pedagogët e secilit Fakultet, një përfaqësues nga personeli ndihmës-akademik ose administrative, një përfaqësues nga Këshilli Studentor, dhe të paktën një përfaqësues ekspert i jashtëm.</p> <p>[Evidenca nr. 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf; Minutat e takimit, Takimi me përfaqësues të Sigurimit të Cilësisë; 30. Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC.pdf]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Në rregulloren e sigurimit të brendshëm të cilësisë përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Komisionit të përhershëm dhe të Zyrës së Sigurimit të Cilësisë. Ata kanë për detyrë të vlerësojnë efikasitetin e veprimtarive mësimore, kërkimore apo artistike si dhe efikasitetin e aktivitetit financiar.</p> <p>[Evidenca nr. 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf;]</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe</p>	<p>Sipas rregullores se sigurimit të brendshëm të cilësisë pjesëtarët janë përfaqësues të Fakulteteve, përfaqësues të stafit ndihmës akademik dhe administrative, përfaqësues të Këshillit Studentor dhe ekspert të jashtëm. Kjo garantohet edhe nga urdhri administrative i Institucionit</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>mbi përfshirjen në KSBC. [Evidenca nr. 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf;]</p>			
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Pika F.VII.3 e rregullores për sigurimin e cilësisë përcakton kriteret e përzgjedhjes se aktoreve sipas profesionalizmit, paanshmërisë, integritetit, ngarkesës mësimorë, eksperiencës në pozicione të ngjashme dhe të mos qënit pjesë e autoriteteve drejtuese të UET në mënyrë që të sigurohet pavarësia. [Evidenca nr. 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf;]</p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Dy janë burimet me nga të cilat ekspertët e jashtëm kanë pjesë aktive në sigurimin e cilësisë: 1. Bordet e Tregut të Punës 2. Eksperti i jashtëm, pjesë e KSBC. [Evidenca nr. 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë.pdf;]</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.5


Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Nga vëzhgimi i ekspertëve të jashtëm, UET ka një sistem të ngritur të sigurimit të cilësisë, të cilën siç edhe përmendet tek raporti i grupit të brendshëm e vë në dispozicion të akademikëve dhe studentëve nëpërmjet sistemeve të tij të brendshme. Por ky sistem i ngritur nuk është publik në faqen e Institucionit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin</p>	<p>Institucioni nuk i publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit në faqen e internetit apo të intranetit të tij, për arsye siç përmenden sensitive dhe personale. Nga takimi me GVJ u përmend që këto raporte i disponoheshin autoriteteve drejtuese të UET dhe pedagogëve në mënyrë të personalizuar. As në dokumentacionin e</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




për të dhënat personale.	disponuar për akreditim ekspertët nuk u ndeshën me raportin vjetor të KSBC, për të gjykuar në lidhje me cilësinë e programit dhe zbatimin e sistemit monitorues të ngritur në bazë të strategjisë dhe politikave të UET.			
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Në mungesë të rezultateve të vlerësimit, GVJ ka vënë re se KSBC ka një plan me objektiva të përcaktuara për të gjithë fushat e vlerësimit, të përcaktuar me instrument dhe raporte në lidhje me to. Nuk është evidentuar një raport final edhe nga KSBC në lidhje me plotësimin e këtyre planeve.			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Përdorimi i disa instrumentave në funksion të sigurimit të cilësisë dëshmon se institucioni vlerëson këtë proces maksimalisht. <i>GVJ vlerëson se Institucioni duhet të investojë më shumë në implementimin dhe efikasitetin e metodave në rritje të cilësisë.</i>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Në planin e tij akademik KSBC parashikon edhe zhvillimin e trajnimeve në lidhje me sigurimin e cilësisë për stafin akademik dhe administrativ. Ndërsa përfshirja e studentëve kryhet nëpërmjet përfshirjes së tyre në strukturat drejtuese dhe KSBC.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Financë” me profile: “Bankë”, “Kontabilitet”, “Informatikë Ekonomike” dhe “Menaxhimi i Organizatave” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Europian i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime:



1. Eksperienca e programit dhe përmirësimi e cilësisë nga viti në vit.
2. Eksperienca e stafit akademik të përfshirë në programin e studimit dhe mbulimi i tij me staf akademik me kohe te plote (98% e stafit që zhvillojnë këtë program janë PAE)
3. Struktura solide që lidhen me mbështetjen e studentëve përgjatë studimeve dhe pas tyre.
4. Një bazë Alumni e fortë për të mbështetur rezultatet e programit në lidhje me të nxënësin, cilësitë dhe aftësitë e të diplomuarve.

Pika të dobëta:

1. Lulahje e fitueshmërisë së Institucionit që mund të vejë në diskutimi vazhdimësinë në një treg që ngushtohet dhe që nuk lë vend për shumë aktorë në fushën e arsimit privat.
(standarti IV.6, kriteret 3, 4, 5)

Rekomandime:

1. Institucioni duhet të intensifikojë punën, procesin e marketingut për të mbajtur të paktën të qëndrueshëm numrin e studentëve të regjistruar në këtë program
2. Zyra e Sigurimit të Cilësisë duhet të riorganizojë instrumentet dhe mjetet e përdorura duke prodhuar një raport monitorimi dhe një plan aksioni në lidhje me gjetjet drejtuar Njësisë bazë në lidhje me programin e studimit. GVJ ka identifikuar një numër të madh metodash për sigurimin e cilësisë dhe një mungesë në organizimin e informacionit të marrë prej tyre si dhe në mënyrën e administrimit të këtij informacioni
3. Institucioni duhet të publikojë/perfshijë në raporte strukturat/proceset/instrumentat e sistemit të sigurimit të cilësisë, për të evidentuar dhe bërë transparent procesin tek të gjitha palët e interesuara.
4. Institucioni duhet të parashikojë me procedurë një plan buxhet, ku nevojat të evidentohen nga Njësitë bazë dhe Senati të ketë një rol më aktiv në lidhje me



miratimin e plan-buxhetit. Nëpërmjet buxhetimit do të konsiderohet edhe vijueshmëria e Institucionit, i cili ka paraqitur luhatje në fitueshmëri.

5. GVJ sugjeron krijimin e një "prospectusi" për programin ku të përfshihen të gjitha lëndët e programit së bashku e të ofrohet si një dokument sqarues tek studentet.

Conclusions of the Evaluation of the first cycle study program Bachelor "Finance" with profiles: "Banking", "Accounting", "Economic Informatics" and "Management of Organizations" of the Institution of Higher Education "European University of Tirana"

Strengths and opportunities:


1. Experienced program that increases quality on year by year basis.
2. Experienced full-time staff in the program (98% of the staff of the program is full time)
3. Solid structures for student support in their studies and as alumni.
4. Solid alumni basis for supporting the results of the program on teaching and learning, quality and skills of graduates.

Weaknesses and threats:

1. Volatility of institution's profitability which creates uncertainty combined also with the narrowing of the private education market. (standard IV.6, criteria 3, 4, 5)

Recommendations:

1. The institution needs to intensify its attempts on marketing processes to keep stable the students number.
2. The QA Office need to re-organize all means and instruments used in the processes of quality assurance and to produce an action plan with findings for all Units regarding the study programs. The external experts have identified a large number of methods on quality assurance and a lack of organization of the information obtained from them as well as in the administration process of this information.



3. The institution needs to publish/include in monitoring reports the structures/processes/instruments of quality assurance to make evident and transparent the process to all interested parties.
4. The institution needs to create a procedure on budgeting, where the needs will be evidenced from the basic units (department/faculties) and the Senate to have a more active role in the approval of the budget. Through budgeting the continuity of the institution will be also evidenced, considering the volatility that it has gone through.
5. The external experts have suggested a prospectus for the program (and other programs maybe) that will include the courses and their description and will be a necessary document for students starting the university.

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Jo përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Adresa: "Ruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

